

Lezhë, më 26.03.2026

PROCESVERBAL

I mbajtur sot, në dt. 26.03.2026, në orën 11:00, në sallën e këshillit bashkiak, në Pallatin e Kulturës Lezhë, mbi mbledhjen e radhës të muajit Mars 2026, të Këshillit të Bashkisë Lezhë.

Mbledhja u hap nga kryetari z. Ndue Luli, i cili lexoi rendin e ditës.

-Ndue Luli: Përshëndetje të gjithëve. Faleminderit për pjesëmarrjen.

Sot kemi mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak Lezhë për muajin Shkurt 2026. Mbledhja zhvillohet me këtë rend dite:

1. Projekt-Vendim “Për heqjen e mandatit si anëtare e Këshillit të Bashkisë Lezhë zj. Rajmonda Aleksander Prendaj”
2. Projekt-Vendim “Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% për periudhën 01-28 Shkurt 2026”
3. Projekt-Vendim “Për miratimin e pagesës së plotë të qirasë sipas vlerës së tregut për 49 (dyzet e nëntë) familje të dëmtuara nga tërmeti i datës 26 Nëntor 2019”
4. Projekt-Vendim “Për ndryshimin e VKB-së nr. 15, datë 25.02.2026 “Për miratimin e pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë, të punonjësve administrativë, të punonjësve mbështetës dhe të masës së shpërblimit mujor të këshilltarëve dhe kryetarëve të fshatrave”
5. Projekt-Vendim “Për dhënien e dakordësisë për vijimin e procedurave për heqjen nga fondi pyjor kombëtar të sipërfaqes pyjore në pronësi private, për ndërtim objekti me funksion banimi dhe shërbime me 1-6 kate mbi tokë dhe 1-3 kate nën tokë nga shoqëria “Dukagjini Group” shpk”.
6. Projekt-Vendim “Për miratimin e Buxhetit Faktik për vitin 2025”
7. Projekt-Vendim “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB nr. 113, datë 15.12.2025 “Për miratimin e PBA-së 2026-2028 dhe Buxhetit të vitit 2026”
8. Projekt-Vendim “Për miratimin e tavaneve të shpenzimeve sipas programeve buxhetore për PBA-në 2027-2029 (Faza e Parë) të Bashkisë Lezhë”
9. Projekt-Vendim “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 15, datë 29.02.2024 “Për miratimin e Programit të Transparencës në Bashkinë Lezhë”
10. Informacion nga ASHK Lezhë për situatën e kërkesave të kalimit në pronësi, pa shpërblim, të tokës bujqësore.
11. Raport për veprimtarinë e Këshillit të Bashkisë Lezhë për vitin 2025
12. Të ndryshme

Ky është rendi i ditës. Kush ka diçka për rendin e ditës? Nuk ka.

Atëherë, kush është dakord me rendin e ditës? Kundra? Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 30 vota PRO. Faleminderit.

Vazhdojmë me projekt vendimin e parë “Për heqjen e mandatit si anëtare e Këshillit të Bashkisë Lezhë, zj. Rajmonda Aleksandër Prendaj”.

Me kërkesën e saj, është dhënë dorëheqja me akt noterial. Kush është dakord? Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 30 vota PRO. Faleminderit.

-Erdhi këshilltari Ervin Coli.

-Ndue Luli: Kalojmë te pika 2, Projekt vendim “ Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri në 6% për periudhën 1-28 shkurt 2026”.

Ka kush ndonjë diskutim për këtë projekt vendim? Jo. Atëherë, kush është dakord? Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 31 vota PRO.

Vazhdojmë me pikën 3, Projekt vendim “Për miratimin e pagesës së plotë të qerasë sipas vlerës së tregut për 49 familje të dëmtuara nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019”.

Fjala për kryetarin e komisionit.

-Agostin Marku: Ky projekt vendim është shumë i domosdoshëm për këto familje, meqenëse është hapur edhe procedura e rindërtimit dhe janë siguruar edhe fondet. Por në mbledhjet e komisioneve u pa e arsyeshme që të bëhet një saksim për vlerën e qerasë. Sot e kanë depozituar të rishikuar atë pikë bashkia. Në qoftë se ka ndonjë sqarim të mëtejshëm nga bashkia, është çështje tjetër. Në parim, jemi dakord që ta kalojmë me këtë saktësimin që ka sjellë bashkia, duke përcaktuar pra vlerën e qerasë, sepse realisht në atë projekt vendim që është depozituar është saktësuar vetëm ajo se sa i takon gjithsecilit në kubaturë 1 plus 1, 2 plus 1, 3 plus 1. Faleminderit.

-Ndue Luli: Mendim tjetër ka? Zonja Ndoj.

-Donika Ndoj: Përshëndetje të gjithëve. Për sa i përket këtij projektvendimi, normal një projekt vendim jashtëzakonisht shumë i rëndësishëm në lidhje me tërmetin, sepse kanë kaluar shtatë vite që nga 2019 që ka rënë tërmeti dhe nuk kanë marrë një zgjidhje përfundimtare problemet me tërmetin. Këtu flasim për bonus qeraje për 49 familje, ndërkohë që flasim edhe për 19 familje të tjera që kërkojnë të trajtohen me bonus qeraje dhe janë përjashtuar. 25 familje të tjera që kërkojnë të trajtohen me bonus qeraje dhe përsëri nuk kanë përfituar. Ndërkohë që qytetarët presin zgjidhje të këtij problemi shtatë vite. Edhe sa vite do të presin këta qytetarë? A po trajtohen me standarde të ndryshme që i themi ne njëri i nënës apo tjetri i njerkës? Pasi qytetarët kanë dosjet e tyre të cilat janë trajtuar sipas komisionit të vlerësimit dhe i kanë klasifikuar në DS4, DS5 dhe dosjet e tyre po pluhurosen pikërisht në shtëpitë e tyre të cilat presin që të marrin vlerësimin e duhur. Ndërkohë që flasim edhe për pesë familje në lagjen Besëlidhja që trajtohen me bonus qeraje. Po në lagjen Skënderbeg keni disa palate, pallati i ish të përndjekurve, pallati numër 16, të cilët janë në rrezik shembje dhe standardet e jetesës aty janë jashtëzakonisht të ulëta. Nuk i keni përfshirë në planin e rindërtimit. A keni një plan konkret për këto familje para se sa të ndodhi pastaj ndonjë tragjedi tjetër? Qytetarët presin jo më që të bien tërmete të tjera por të zgjidhet ky problem njëherë. 2019-2026, edhe sa vite duhet që t'i trajtojmë ato? Ju patjetër do të justifikoni me VKM dhe me aktet e tjera ligjore dhe nënligjore, por përballë kanë qeverinë,

përballë kanë bashkinë dhe ju do i trajtoni sepse këtu keni ngritur komisionin e verifikimit në lidhje me dëmtimet e tërmetit, komisionin e ankimit në lidhje me përfituesit e bonusit të qerave. Kështu që duhet t'i jepni një përgjigje këtyre qytetarëve. Asgjë tjetër më shumë. Faleminderit.

-Ndue Luli: Faleminderit. Fjala për kryetarin e bashkisë.

-Pjerin Ndreu: E kuptoj shqetësimin e zonjës, por para se të bëni politikë duhet të kuptoni sistemin si funksionon njëherë. E para e punës ne kemi adresuar mbi 90% të nevojave deri më sot, zonja këshilltare, dhe jemi për mos me thënë bashkia në avangardë të zgjidhjes së këtyre problemeve në bashkëpunim me qeverinë se programi i rindërtimit nuk është program bashkie por është program qeverie që ta kesh të qartë. Të lutem a mundet ta sqaroj tashti? Të dëgjova e pashë se e kishë parapërgatitë me konsulencë, po me konsulencë të paditur. Kështu që problemi është këtu, që ne nuk marrim vendim as për shembje pallatesh si bashki e as për nxjerrje jashtë pa një akt ekspertimi dhe vendimmarrje të Institutit të Ndërtimit. Pra nuk jemi ne. Ne kemi evidentuar disa banesa, meqë dole jashtë tërmetit, që mund t'i shikojmë për t'i shembur për shkak kushteve të rënda por nuk mund t'i adresojmë te programi i tërmeti se tërmeti siç thatë ju, ka shtatë vjet dhe ne është e pamundur. Në atë kohë janë vlerësuar të gjitha një për një kush ka pasur një ankesë. Kemi shkuar ne paraprakisht, ka ardhur instituti i ndërtimit i ka vu vulën kësaj pune, se kam dëgjuar dhe nga këto historitë e fantazive tuaja politike që ne kemi bërë diferencim si e thatë ju. Ne s'kemi pasur të drejtën e vendimmarrjes sa për dijeni. Ne si bashki s'kemi marrë vendim për këtë punë. Të gjitha vendimet janë me firmë, me akt ekspertimi të specialistëve të fushës. Pra ne nuk na është lënë asnjëherë në dorë të vendosim se duhet ky apo s'duhet ky. Ne jemi njësi zbatuese, nuk jemi njësi që marrim vendim që ta qartësoni gjënë dhe mos të kërkonit gjilpërën në kashtë ose të më fokusoni mua si problematiku që bëra ndarjen, njërit ia dhashë e tjetrit s'ia dhashë. Po t'i marrim politikisht dhe t'i shtrojmë në tavolinë, i bie se shumë janë votuesit tuaj dhe ne s'kemi parë për atë punë fare dhe nuk kemi ndër mend me i pa për atë muhabet, që të jemi të qartë në këtë lloj tymnaje. Sot që po flasim, ne, pas heqjes dorë të qeverisë nga bonusi i qerasë, e kemi marrë ne si bashki në dorë dhe sa për dijeni, ne nuk kemi lënë as edhe një familje që i takon me ligj, pa trajtuar me bonus qeraje dhe e paguajmë ne nga lekët e taksapaguesve lezhjanë, por të mos lënë as edhe një familje në rrugë, ndërkohë që ne po bëjmë pallatin për 16 familje aty dhe së shpejti pretendojmë që qeveria të na zgjidhë një problem që ka lidhje me një paqartësi të një situatë të re ku është dhënë fondi nga qeveria, është prokuruar sa për dijeni ndërtimi i 40 shtëpiave individuale që na kanë ngelur, por me ndryshimet e çmimeve në treg ka ndryshuar dhe qasja e firmës e cila u tërhoq nga investimi dhe ne kemi kërkuar fond shtesë. Sot që flasim ne kemi fondet tona si bashki që do t'i shtojmë por duhet të ndryshuar baza ligjore në qeveri dhe mendoj se do ta ndryshojmë. Pra ne nuk i kemi lënë njerëz jashtë. Ne i kemi dhënë bonusin e qerasë dhe në momentin që kemi dhënë bonusin e qerasë i cili është miratuar këtu në këshill, nëse keni rast ku ne bonusin e qerasë e kemi lënë kështu në përzgjedhje politike apo kështu fare fisnore apo simpatie tone, ke mekanizma ligjore, mund t'i çosh atje. Nuk ka ndodhur as edhe njëherë. Është strik e qartësuar se kujt i takon, kujt s'i takon dhe arsyeja pse, se ka njerëz që duan lekë pa shkak unë e di por në Bashkinë Lezhë nuk ka ndodhur as edhe njëherë e s'ka për të ndodhur kurrë që të ketë një diferencim për arsye politike krahinore fare fisnore e ku e di unë çfarë mund të ketë, kurrë as ka ndodhur as ka për të ndodhur as keni për të gjetur kurrën e kurrës. Ky program normalisht që është zgjatë në kohë për arsye të turbulencave që thamë.

Ajo që ngreni ju se disave u janë bërë akte ekspertime, janë një vit pas. Pra të gjitha ato vlerësime janë një vit pas por që qeveria nuk i ka adresuar dhe nuk i ka parë të arsyeshme për arsye se ka konstatuar që një vit pas disa kanë dalë dëmtime që kanë qenë prej kohësh, jo prej tërmetit dhe i ka vlerësuar për jo deri tani. Në momentin që do t'i vlerësojnë, ne njësi zbatimi jemi, ne themi po, ne nuk themi jo. Fakti që ne i kemi çuar atje do të thotë që ne e kemi kryer punën tonë dhe fakti që ne i kemi çuar atje dhe emrat që i kemi çuar atje që mund t'i bëjmë publike kur të doni ju, ti do të kuptosh qartësisht se aty s'kemi bërë asnjë lloj dallimi fare, zero dallim nga ato që mendoni ju. Kështu që kjo mënyra juaj për të treguar se ne i ndamë është është për me bë politikë, me bë sikur, por realiteti është totalisht ndryshe, komplet.

Zonjë ju lutem, unë nuk kam shmangë asgjë, se ti e ke marrë një here, unë e kam marrë 500 herë shqetësimin e qytetarëve dhe në qoftë se ty të kanë ardhur një herë te dera, mua më vijnë përditë dhe o ka një interlokutor të fortë në këtë punë që jemi ne me qeverinë, o s'ka, o ne kemi ushtruar trysni o s'ka, o ne jemi bashkia që kemi shkuar më afër fundit, jemi në kilometrin e fundit të adresimit të situates, nuk ka tjetër, hajde ta bëjmë publike ne vetëm 49 shtëpi na kanë ngelur për t'i bërë që do t'i adresojmë shumë shpejt. Jo më larg se para dy ditësh ne kemi bërë një skemë se si mund të bëhet, duhet një ndryshim ligjor që fondin për strehimin ne ta kalojmë në mbylljen e kësaj historie dhe ne e mbyllëm komplet por nuk i kemi lënë jashtë, i kemi dhënë bonusin e qerasë dhe ka një përpjekje për të thënë janë në çadër, s'ka çadër, kush do të rrijë në çadër, të rrijë, por lekët i merr në bashki një për një, pastaj se gjen shtëpi me qera, se s'gjen, se don, se s'don, ky është problemi i disave, s e kam parë njerëz që shkojnë në çadër, cila çadër, në çadër njëri që merr bonus qeraja në bashki. Po bonusi i qerasë për çfarë është, për të gjetur shtëpi. Dhe e paguajmë ne, domethënë kur them ne, gjithë ky këshill që është këtu e miraton dhe i paguajmë ne. Këtu i marrim vendimet se ne nuk e vendosim vetë, ne e bëjmë listën, nëse ti konstaton në listë se ka një gjë që nuk shkon, që nuk është në rregull po, ne mbajmë qëndrim, po nuk ndodh. Kanë bërë ankesa në Bashkëqeverisje, kanë bërë në SPAK, kanë thënë s'na e japin por kur kanë ardhur e kanë verifikuar ka datë tjetër ndryshe. Dhe nuk është një verifikim zyrtar që bëhet po janë të paktën mbi 30 verifikime zyrtare që ne na kanë ardhur dhe jemi detyruar me dhënë përgjigje, jo njëherë po 500 herë. Kanë shkuar në prokurori, prapë është parë dokumentacioni prapë ne kemi dalë në rregull. Nuk bëjmë gafa me këtë punë, edhe njëherë fiksojeni mire, nuk luajmë qimen e flokut me standardet e rregullat e normat nëse i takon apo nëse s'i takon, çdo lloj insinuate tjetër pastaj është në qejfin e gjithkujt, unë nuk e ndal, por unë jam i detyruar publikisht me e thënë këtë saktë dhe qartë.

-Ndue Luli: Fjala për nënkryetarin e bashkisë.

-Fatjon Zefi: Në mbledhjen e komisionit është konstatuar një mungesë për miratimin e pagesës së plotë të qerasë sipas vlerës së tregut. Në vendimin e këshillit të bashkiak nr 93, datë 30.10.2025 janë përcaktuar edhe vlerat e këtyre qerave të cilat janë për 1 plus 1, 18.250 lekë, për 2 plus 1, 25.100 lekë dhe për 3 plus 1, 30.700 lekë. Duke qenë se janë rritur dhe çmimet e qerave domethënë do vazhdohet të paguhet me këto vlera që janë miratuar po me vendim të këshillit bashkiak.

-Ndue Luli: Faleminderit. Tjetër ka kush diçka? Nuk ka. Kush është dakord me projektvendimin? Miratohet me 30 vota Pro. Këshilltarja Donika Ndoj votoi Abstenim. Faleminderit.

Kalojmë te pika 4, Projektvendim “Për ndryshimin e VKB-së nr. 15, datë 25.02.2026 “Për miratimin e pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë, të punonjësve administrative, të punonjësve mbështetës dhe të masës së shpërblimit mujor të këshilltarëve dhe kryetarëve të fshatrave””

Fjala për kryetarin e komisionit të financës.

-Agostin Marku: Është një saktësim që e lamë detyrë edhe në mbledhjen e kaluar për të bërë unifikimin edhe për pagat e administratës pra jo vetëm për pagën minimale siç e bëmë në mbledhjen e kaluar. Vjen ky ndryshim si rezultat i vendimit të qeverisë për saktësimin e 2.5 %. Është bërë një punë e mirë nga bashkia, janë saktësuar shumë pozicione të administratës, janë në nivelet maksimale të pagës çka mund të motivojë gjithsecilin punonjës që të realizojë sa më mirë dhe në mënyrë profesionale programin e bashkisë në shërbim të qytetarëve. Ju ftoj që ta miratojmë. Me këtë mbyllet gjithë cikli i rritjes së pagës mbi bazën e vendimeve të qeverisë. Faleminderit.

-Ndue Luli: Kush e do fjalën tjetër? Po zonja Ndoj.

-Erdhi këshilltari Edlir Reçi.

-Donika Ndoj: Përsa i përket çështjes së pagave të administratës, normal që jam dakord për rritjen e pagave të punonjësve, të nëpunësve, pasi një punonjës dhe nëpunës i mirëpaguar normal që është më eficient dhe më produktiv në punë. Edhe muajin e kaluar e kam ngritur si shqetësim, Lezha është e vogël në fakt për të marrë informacione, ajo çfarë kam vërejtur unë do ta them dhe me rast konkret është sepse është vërejtur që kohët e fundit, muajt e fundit ka punëtorë të shtuar në administratë çka do të thotë pak një tejfryrje në administratë. Kjo ndoshta për të mos thënë sepse do të hymë dhe në vit elektoral dhe është për qëllime elektorale. Do ta them konkretisht sepse në një shkollë se dhe Erini herën tjetër tha normal se çfarë janë këto komunikime të tilla në lidhje me punësimet, por në një shkollë para një muaji thotë u shtu një sanitare, ndërkohë që aktualisht aty janë pesë sanitare, shkolla dy katëshe me 400 nxënës ndërkohë që para 10 vitesh ka qenë me dy sanitare me 900 nxënës edhe me tre kate shkollë. Kështu që më duket se është pak e teprume, po largohen nxënësit dhe po shtojmë sanitarët, pesë sanitare një shkollë që ju mund ta shikoni vetë, e verifikoni vetë dhe është absolutisht që është e saktë e vërtetë domethënë, edhe për sa i përket një diskutimi që kena bë dhe për personat të cilët kanë mbushur moshën për të dalë në pension dhe i punësuari i fundit ka qenë më 6 mars, një person që ka mbushur moshën me dalë në pension dhe ju e keni vënë në një rol përgjegjës. Kështu që hapuni krah të rinjve e të rejave sepse s'kanë si të fitojnë përvojën e punës ata në qoftë se ne nuk i fusim në punë sepse kemi shkolla profesionale që normal që i edukojnë dhe i arsimojnë nxënësit në këto profile apo të rriturit kryefamiljarë zonja që mund t'u hapim rrugë, përndryshe kështu do të largohen nga vendi. Do të thuash përsëri për qëllime politike, por dhe është edhe normal pastaj Kontrolli i Lartë i Shtetit që do ta gjejë dhe me shkelje në lidhje me këto drejtime dhe kështu që të jena korrekte.

-Pjerin Ndreu: Do ta gjejë, e di ti që do ta gjejë me shkelje.

-Donika Ndoj: Atë e dini ju.

-Pjerin Ndreu: E di ti që e thu . Çfarë shkelje do gjejë?

-Donika Ndoj: Po për sa kohë aty ka persona të cilët e kanë mbushur moshën për të dalë në pension dhe ju i mbani përsëri në punë, besoj se shkelje mund të jetë kjo.

-Pjerin Ndreu: E para e punës mos u ngatërroi brenda katundit njëherë se s`ju shkon brenda katundit me sha njëri tjetrin.

S`ju shkon ajo punë, të paktën po flasim kështu njerëzisht, këtë diskutim mund ta bëje ditën kur ne kemi bërë projektbuxhetin këtu dhe kemi nominuar disa shtesa dhe dy janë shtesat që ta dish, në structure, është një njësi e mirëmbajtjes së rrugëve sepse grupi që kishim ne nuk na dilte, ne kemi materiale por nuk i shpenzojmë dot, s`kemi grupe pune dhe ne kemi marrë punëtorë për të shtruar trotuare e do fillojmë tani në Shëngjin me dy brigada dhe duhet të ecim më shpejt. Pra kemi shtu një brigadë e këtu kemi qenë në këshill. Po ta kishe bërë këtë muhabet atëherë ok, po jeni kujtuar me vonesë. Kush e di ku keni bërë ndonjë muhabet. Edhe e dyta është njësia e pastrimit që normalisht ikën nga lekët që u jepnim kompanive dhe vijnë në bashki, normalisht që dhe do marrim punëtorë do marrim shofera, do marrim punonjës që do punojnë nëpunë njësi, ashtu si i ka pasur kompania, do i marrim ne tashi. Dhe normalisht do i paguajmë ne direkt se është një ndërmarrje që e kemi krijuar këtu me këshill, ke qenë këtu dhe normalisht s`besoj se s'e ke pa atë projektbuxhetin se shtohen njerëzit në punë aty në skemën e re të pastrimit, që ne e kemi promovuar dhe në fakt që normalisht shoqërohet me shtim punonjësish dhe nuk kemi marrë ndonjë njeri. Tani zonjë jemi në këshill dhe nuk lejohen disa gabime. Sanitaret janë funksione të deleguara që paguhet nga shteti, nga qeveria. Shtohet apo ulet një sanitare, nuk ka të bëjë me ne. Ne bëjmë një propozim sepse shkolla e Shënkollit ku thua ti, është një shkollë e bërë dhe është e madhe dhe ka lindur e nevojshme që të shtohet një sanitare për shkak të kapaciteteve të shtuara të shkollës që dihet se nuk është ajo shkolla që ka qenë po është shumë më e madhe sesa ka qenë. Po, por jo në numër, por në territor. Referenca me numër nxënësish edhe referenca me territor janë dy aspekte që plotësojnë njëra-tjetrën dhe ti nuk mund të thuash për një shkollë me 5000 m² po supozoj, e një shkollë me 1000 m² për të njëjtin numër të nxënësish nuk është e njëjta gjë në kuptimin e mbajtjes së ambientit. Pra kjo është një gjë që unë për vete, po të isha në vendin tënd, nuk do preferoja me e kap me dorë sepse është shumë banale të diskutohet ky muhabet. Sanitaret kanë një proces pune aty që nuk varet prej meje dhe nuk e paguajmë ne me taksat e bashkisë, e paguan qeveria. Gjysma të vijnë ty, Vota të pastra të shumë sanitareve të bashkisë të vijnë ty e të ujësjellësit e të punonjësve të tjerë. Këtu jetojmë, nuk i ka pa kërkush për atë punë. Nuk e banalizojmë politikën ne, ju e keni merak. Sot shkolla "Gjergj Kastrioti" më kërkon sanitare me shut, e roje, sepse është tjetër strukturë shkolla tashi, nuk është struktura e shkollës që ka qenë, e ti thu pse është shtu sanitare se u bënë nami se politikisht ne kena punësu njerëz, është banale me u diskutu në këshill kjo. s`është muhabet për këshill.

Tashti atë personin që thu ti që e ke dhe nga zona edhe e ke me marak të madh e që ka dalë në pension, e kemi marrë ne në punë, e kam marrë unë, për të zëvendësuar një periudhë, është zëvendësues sa për dijëni, nuk është në punë, është zëvendësues, sepse një person ka një proces

diku dhe nuk është për momentin në punë. Për shkak të përvojës, për shkak të njohjes së terrenit e për shkak të disa nevojave që kemi ne te emergjencat se është absolutisht një ndër pikat më të nxehta që ne kemi dhe na duhet një njeri që e di terrenin, ne e kemi thirrë për një periudhë të shkurtër, derisa të kthehet ai zotëria që është aty. Pra mos u mërzisni, ka rrezik që deri në zgjedhje s'e keni aty edhe qetësoheni. Vetëm problemi është se nuk do e keni në punë po do e keni në fushatë.

-Ndue Luli: Ka kush gjë tjetër? S'ka. Kush është dakord me projektvendimin? Miratohet me 31 vota Pro. Këshilltarja Donika Ndoj votoi Abstenim. Faleminderit .

Vazhdojmë me pikën 5, Projektvendim “Për dhënien e dakordësisë për vijimin e procedurave për heqjen nga fondi pyjor kombëtar të sipërfaqes pyjore në pronësi private, për ndërtim objekti me funksion banimi dhe shërbime me 1-6 kate mbi tokë dhe 1-3 kate nën tokë nga shoqëria “Dukagjini Group” shpk”

Në lidhje me projektvendimin duhet të sqarojmë që është bërë dëgjesa publike sipas njoftimit që e kemi pasur të gjithë.

Fjalën e ka përgjegjësi i pyjeve pranë drejtorisë së bujqësisë së bashkisë zoti Palushi.

-Artan Palushi: Përshëndetje të gjithëve. Atëherë kemi të bëjmë me një procedurë të heqjes nga fondi pyjor kombëtar të një sipërfaqeje pyjore private mbi të cilën është lëshuar një leje nga Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujërave. Ka një vendim të datës 28.05.2025, vendimi nr. 22 për miratimin e lejes së ndërtimit. Duke qenë se kjo sipërfaqe është e llojit të pasurisë pyll kërkohet ndryshimi i kategorisë së përdorimit të kësaj sipërfaqeje mbi të cilën do të zbardhet leja dhe do ndërtohet objekti siç është parashikuar në vendimin e lejes së ndërtimit. Dhe për këtë i takon këshillit bashkiak që të marrë vendimin për dhënien e dakordësisë për vijimin e procedurës për t'ia përcjellur më pas ministrisë së mjedisit që do të dalë me aktin e urdhrat të ministrit për heqjen nga fondi pyjor. Kërkesa ka ardhur nga Ministria e Mjedisit, i është përcjellë bashkisë për përgatitjen e raportit teknik dhe vendimin e këshillit bashkiak. Bëhet fjalë për një sipërfaqe 2633 metra katrorë ose 0.2633 hektarë pyll që do të ndryshohet kategoria sipas miratimit final.

-Ndue Luli: Faleminderit. Kush e do fjalën? Zonja Marku.

-Alfrida Marku: Faleminderit për fjalën. Për të shtu një koment për atë që u diskutu në pikën pararendëse. Në fakt bashkë me nja 20 prindër të shkollës “Gjergj Kastrioti” kemi nja gjashtë muaj që kërkojmë të na mundësohet një roje për këtë shkollë për sa kohë janë dy shkolla nëntëvjeçare që ndajnë të njëjtin oborr të përbashkët. Kështu që unë shpresoj që konfirmimin ta marrim pse jo edhe në këtë mbledhje për këtë shqetësim të drejtë të prindërve.

Për të vijuar për pikën konkrete që po diskutojmë, absolutisht që zhvillimi i infrastrukturës e udhëheq zhvillimin e turizmit por në të njëjtën kohë institucionet përgjegjëse përfshirë edhe ne duhet të angazhohemi për mbrojtjen e asaj që natyra na ka dhuruar me qëllim që të bëjmë të mundur zhvillim të qëndrueshëm të turizmit, rrjedhimisht zhvillim të qëndrueshëm të ekonomisë vendore e në këto kushte të bëjmë të mundur edhe atë që është më e rëndësishmja, balancimin e interesit publik me atë privat. Unë kam marrë pjesë në dëgjuesën publike të zhvilluar posaçërisht për këtë pikë të rendit të ditës dhe në atë mbledhje sikurse edhe sot, u kam parashtruar

përfaqësuesve të bashkisë, në atë dëgjesë publike që është e domosdoshme që nga ana e bashkisë Lezhë të përshpejtohen dhe të konkretizohen hapat për të bërë të mundur kompensimin e ekonomisë pyjore që asgjësohet në një sipërfaqe tjetër aty ku ka nevojë për t'u rijetësuar fondi pyjor. Nga ana tjetër sa kohë flasim për zhvillimin e turizmit e posaçërisht në zonën bregdetare unë shfrytëzoj këtë mbledhje për t'i kujtuar bashkisë Lezhë domosdoshmërinë e ndërmarrjes së një tjetër hapi konkret dhe mjaft të rëndësishëm për nisjen e një projekti me qëllim parandalimin e pasojave të mëtejshme të fenomenit të erozionit në zonën e Kunes dhe Vainit. Pra në të njëjtën kohë ne i hapim rrugë zhvillimit të turizmit të zonës bregdetare por nga ana tjetër siç e thashë edhe në fillim duhet të mbrojmë atë çka natyra na ka dhuruar dhe parandalimi i pasojave të përshpejtuara të fenomenit të turizmit në zonën e Kunes dhe të Vainit është një hap i domosdoshëm që unë besoj dhe mendoj se ka ardhur koha që bashkia Lezhë të marrë hapa konkretë. Faleminderit .

-Ndue Luli: Faleminderit. Tjetër kush e do fjalën? Po zoti Palushi .

-Artan Palushi: Pata diçka shtesë në lidhje me këtë shqetësimin e mbrojtjes së mjedisit. Në rastet kur hiqet nga fondi pyjor, në aktin e miratimit që do të jetë urdhër i ministrit apo vendimi i këshillit të ministrave, caktohet sipërfaqja që e detyron kompaninë të bëjë rehabilitimin mjedisor ose pagesën e pyllëzimit kompensues. Në rastin tonë bëhet fjalë që të bëhet si rehabilitim trefishi i sipërfaqes që është 0.79 hektarë dhe për këtë i bie një vlerë e përafërt se nuk është nxjerrë vlera fiks pasi duhet të presim aktin e miratimit, një vlerë e përafërt rreth 1.4 milionë lekë të reja pagesë e pyllëzimit kompensues që kompania ia paguan bashkisë dhe bashkia vazhdon me zbatimin e kësaj procedure pastaj, hartimin e projektit dhe procedurën e tenderit dhe zbatimin e projektit teknik që është pyllëzimi.

-Ndue Luli: Në lidhje me këtë, meqënëse zoti Artan sqaroi, edhe në dëgjesën publike është cilësu meqënëse keni qenë dhe ju zonja këshilltare, që në fillim të vitit tjetër bashkia do të raportojë në këshillin bashkiak për gjithë punën që ka bërë për rehabilitimin e sipërfaqeve pyjore të atyre zonave të cilat u janë dhënë në përdorim privatëve për ndërtime siç po miratojmë dhe këtë të sotshmin. Pra bashkia do të raportojë se si është sipas këtij vendimi që tha dhe përgjegjësi i pyjeve.

-Artan Palushi: Duhet sqaruar që teknike dhe ligjore, ndërhyrja me pyllëzime është muaji dhjetor, fundi i vitit. Këto janë gjëra teknike që janë të vendosura edhe në ligj dhe për këtë kërkohet hartimi i projektit dhe miratimi nga organet qendrore që është Agjencia Kombëtare e Pyjeve. Pra ne do hartojmë projektin, do ua dërgojmë atyre për miratim dhe do e zbatojmë në dhjetor sepse shikohet që shumë herë kryen këto në kohën e gjelbërimit, gjelbërimi i rrugëve, i shesheve që nxirren nga vazot dhe vendosen në vend aty për ta gjelbëruar por nuk është e njëjta skemë në rastin e pyllëzimeve. Është i vendosur teknikisht dhe ligjërisht muaji dhjetor, muaji i pyjeve. Pra do parashikohet gjithçka dhe do zbatohet në dhjetor, duke bërë të gjithë procedurën që unë e thashë më pare.

-Ndue Luli: Qartë. Po zoti Ndreca.

-Erin Ndreca: Përshëndetje. Thjesht doja të bëja një sugjerim. Nuk e di nëse ka bazë ligjore por ky është mendimi im. Duke dëgjuar dhe Artanin, nuk e di sa është e mundur që për shkak të

këtyre shpyllëzimeve që ne bëjmë dhe detyrimeve që u përcakton ligji ose për të rijetësuar sipërfaqe të dëmtuara ose për të bërë pagesa, mendoj që athua ka ndonjë hapësirë ose ndonjë mundësi ligjore që këto të bëhen pagesa dhe ana financiare për shembull të financohet tek zjarrfikëset sepse e kam këtu, dëmtimet që ndodhin vetë natyra i riparon ndërsa dëmtimet që na vijnë vit pas viti mbase mund të ndikojmë me gjëra teknike për të parandaluar. Ky është një mendim im. Nuk e di sa mund të vlejë. Gjithsesi faleminderit.

-Ndue Luli: Faleminderit. Ka mendim tjetër? Zonja Ndoj po.

-Donika Ndoj: Atëherë përse i përket këtij projektvendimi në fakt po flasim për gjelbërim dhe siç po na thotë dhe zoti Palushi se para dy vitesh na pati thënë që do të rehabilitohen edhe ato pyjet që u dogjën ku zona e Rrencit apo pjesa e Kunes u përfshinë nga flakët ku u dogjën dhjetra hektarë domethënë, rastësisht apo, por ajo çfarë dihet është sepse, ku e di unë rastësisht apo me dashje, por ajo çfarë dihet sot është sepse pas këtij zjarri kanë lulëzuar kantjere ndërtimi pikërisht në këto zona. Ne nuk po flasim për një sipërfaqe, nuk është sipërfaqe e madhe 2633 metra katrorë, por po flasim pikërisht për betonizimin e kësaj zone e cila është një zonë në fakt delikate që ka të bëjë me turizmin ku kemi atë bukurinë natyrore detin malin gjelbërimin në të cilën po zvoglohen sipërfaqet pyjore, po përparon ai shkaku i erozionit apo prishjen e ekuilibrave natyrorë. Pikërisht ky betonizim do të ndikojë dhe në sipërfaqen e gjelbërt, në zvogëlimin e sipërfaqes së gjelbërt. Thashë edhe njëherë nuk flasim për këtë objekt ndërtese që është gjashtë kate mbi tokë dhe tre kate nën tokë. Po flasim për ato objektet e tjera të cilat janë legalizuar apo dhe papërfunduar me objekte shumëkatëshe në këtë territor. Ndërkohë që pranë bashkisë vepron një strukturë e veçantë që është inspektoriat i vendor i mbrojtjes së territorit dhe normal që pse do të jetë në terren për t'i pa këto shkelje dhe ky inspektorat IVMT-ja a ka dalë në terren, a ka parë shkelje të tilla të këtij mbishfrytëzimi të kësaj zone të bukur të Shëngjinit.

-Ndue Luli: Fjala për kryetarin.

-Pjerin Ndreu: E para e punës, që ta djegim ne malin se du me u bo ndërtim aty, s'kemi pasur nevojë se me bashkinë që drejtonit ju, ku ka qenë edhe zonja këshilltare zv/kryetare, është miratuar në këshill me propozimin e bashkisë, një plan rregullues i qytetit, ku ajo zonë në fakt është vënë si shenjë ndërtimi jo prej meje, është zonë ndërtimi e propozuar këtu dhe e miratuar në qeveri, që të jesh e qartë, që këto përrallat që tregoni poshtë e përpjetë, që ne i dogjëm se dum me bo ndërtim aty, këto s'kanë lidhje se ajo zona ku thoni ju që e dogjëm ne gjoja, që po mos të ishim ne do ishte Shëngjini shkumb sot, shkumb, po nuk është vendi për ta diskutuar më gjatë këtë punë si u bë si si u parandalua, po mos i fryni më këtij zjarri se është një argument që ju bie kresë. Zonën e ndërtimit e ka të përcaktuar bashkia para se me ardhë unë kryetar bashkie, me vendim këshilli, me propozim nga këshilli, i miratuar këtu dhe i çuar në qeveri dhe i miratuar në qeveri. Që ta dish, ne s'kemi shtu as edhe një pëllëmbë se nuk na lejohet ligjërisht ndërtimi jashtë asaj. Për ato që i lexon në Facebookun e atij shefit tënd ti, ka akt kostatime, ka çështje penale sa për dijeni, që të qetësoheni, në prokurori, ka procese penale mbi të cilët ne nuk dalim dot. Ju keni maraqe personale me njerëzit po mos u bëj instrument të një loje personale e cila s'ishte kërkund por që ju identifikon si njerëz që shihni njërin, e merrni inat dhe oburra t'i biem në qafë. Se ku burojnë këto gjëra unë e di se unë jam këtu dhe sa për dijeni jam shumë i vëmendshëm ndaj detajeve, nuk jam nga ata që i kaloj pa i parë, pa i dëgjuar, pa i vlerësuar. Di që ka një çështje

penale të organizuar, ka një bllokim sekuestro, por ju nuk e dini se s'jetoni në realitetin këtu. Ka zhvillime të duhura jo për një po për shumë çështje në fushën e ndërtimit, s'ka asnjë gjë për t'u çuditë, kështu që me u qetësu, me u relaksu, mos me akuzu kërkënd se s'keni pse akuzoni kërkënd, ne jemi shumë të qetë karshi çdo lloj zhvillimi që po bëhet dhe duke ardhë te e fundit, te kjo që themi, jo gjelbërimi, jo gjelbërimi, ai kolegu juaj politik i shpjegoi shumë mirë këto gjëra edhe besoj se domethënë argumenti i atij pi ujë më shumë se i imi në këtë rast.

Janë 20 arkitektë të huaj, çdo projekt që miratohet sot në KKT ka vulën e një prej studiove më të mira në Europë dhe deri në Japoni, së shpejti, nuk e di ndoshta s'ka nevojë për këshill, po vjen Zamir Mane dhe këto ditë i zbardhet leja për në Tale, vjen prapë Dukagjini në Tale, vijnë prapë japonezët në Kune, vijnë italianë tre katër arkitektë francezë austriakë, domethënë janë të paktën 20 arkitektë, çdo projekt që miratohet në KKT vjen me vulën e projektin e një prej studieve më të mira në Europë që ta dini ju saktësisht, pra nuk është një gjë që ne e kemi lëshuar pa duar, por bashkë me qeverinë po adresojmë një histori e cila duhet të dalë përmbi çdo lloj dëmi që është bërë edhe me ato zbardhjet e lejeve të ish-komunave, se po të hyjmë ta bëjmë këtë diskutim, kam frikë se ngelni vetë brenda, po nuk do hyjmë, unë s'e kam hapur për vete atë diskutim dhe nuk kam pse e hap sepse ka një një derë atje që quhet prokurori e gjykatë dhe unë s'kam pse e diskutoj fare dhe është në proces sa për dijeni, që të qetësoheni, po çdo zhvillim që vjen, nuk vjen për ta dëmtuar, po vjen për ta rikuperuar më shumë sesa dëmton dhe kjo është me ligj, nuk është me qejfin tim. Çdo lloj diskutimi që keni, çdo lloj hamendësimi që keni, çdo lloj dyshimi që keni, ju lutem shumë adresojeni në organet përkatëse, adresojeni, jo me letra anonime, i bëni nëpër zyra e lëshoheni me letra anonime, jo me anonime, me emër me mbiemër, ju e keni ndërtuar gjithë filozofinë me letra anonime po unë nuk preferoj kesi gjërash, futeni dhe në një zyrë noterie aty që ju bën letrat edhe bëjini paketë

Ky fondi pyjor është pjesë e një ndër projekteve më fantastike që ka Shqipëria, Dukagjini Group që jo më larg se para 10 ditësh ka konkuruar në Kanë, ka qenë një ndër projektet e përzgjedhura për të konkuruar në Kanë dhe sa për dijeni, vetëm interesi i blerësve aty nga gjithë bota e ka rritë çmimin në nivele gati të Kroacisë, e ka barazu, e ka kalu, për shkak të atij projekti ka kalu edhe Dhërmium e Palasën ai projekt dhe ka tërheqë vëmendjen e turistëve e të njerëzve nga shumë vende të botës, jo shqiptarë, dhe në një mënyrë apo një tjetër na ka bërë një promovim të turizmit duke u fokusuar njerëzit e duke thënë ç'është ky projekt që po ndodh në Lezhë dhe është bërë nga një ndër arkitektët më të mirë në Europë nga Austria

-Ndue Luli: Kush është dakord me projektvendimin? Miratohet me 31 vota Pro. Këshilltarja Donika Ndoj votoi Abstenim. Faleminderit.

Kalojmë te pika 6, projektvendim “Për miratimin e Buxhetit Faktik për vitin 2025”.

Fjalën e ka kryetari i komisionit të financës.

-Agostin Marku: Është një projektvendim që ligji e kërkon që të kalojë në këshillin e bashkisë pas mbylljes së treguesve financiarë nga ana e bashkisë. Treguesit flasin për një rritje pozitive si të të ardhurave por edhe një kontroll të rreptë të shpenzimeve nga ana e bashkisë, gjithçka është nën kontroll për të mos krijuar ato probleme të cilat kanë qenë shumë vite më parë. Fakti i një kontrolli të rreptë të shpenzimeve duke e mbajtur në përputhje me të ardhurat është pozitiv dhe

trëgon për një menaxhim të mirë financiar nga ana e bashkisë, gjithashtu edhe fakti i rritjes së përqindjes së realizimit nga viti në vit i të ardhurave flet për një përvojë tashmë të krijuar dhe që në të ardhmen besojmë se do të jetë edhe më mire, kështu që ju ftoj që ta miratojmë këtë projektvendim. Faleminderit

-Ndue Luli: Faleminderit. Ka kush ndonjë mendim? Nuk ka. Kush është dakord me projektvendimin? Miratohet me 30 vota Pro. Këshilltarja Donika Ndoj votoi Abstenim. Këshilltari Emanuel Perjaku nuk votoi.

-U largua këshilltari Edlir Reçi.

-Ndue Luli: Vazhdojmë me pikën 7, projektvendim “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB nr. 113, datë 15.12.2025 “Për miratimin e PBA-së 2026-2028 dhe Buxhetit të vitit 2026””. Fjalën e ka kryetari i komisionit të financës.

-Agostin Marku: Është një projektvendim që jemi të detyruar ta marrim çdo vit pas rakordimit që bën aparati i bashkisë me degën e thesarit. Në përgjithësi, të gjitha tepricat që kanë dalë pas rakordimit, adresohen në të njëjtat drejtime që kanë krijuar deficite gjatë vitit të kaluar për të mos realizuar si për çështjen e prokurimeve apo zërave të tjerë të shpenzimeve. Pozitiv është fakti që një pjesë e konsiderueshme e këtij fondi shkon për rindërtimin, por edhe për investime të tjera në infrastrukturë të specifikuar si asnjëherë tjetër në këtë projektvendim, ndaj urojmë që të realizohen sa më shpejt, të konkretizohen pra, dhe të kemi një përmirësim të ndjeshëm në infrastrukturë por edhe zgjidhjen njëherë e mirë të problemeve të rindërtimit. Faleminderit.

-Ndue Luli: Faleminderit. Ka kush mendim? Nuk ka. Atëherë kush është dakord? Miratohet me 29 vota Pro. Këshilltarja Donika Ndoj votoi Abstenim. Këshilltari Emanuel Perjaku nuk votoi. Faleminderit.

-Pjerin Ndreu: Një koment për abstenimet. Abstenojnë se jemi në vitin e dytë buxhetor që ne shkojmë pa borxhe dhe sivjet nga gjithë faturat që i likuidojmë këtë vit, ne dalim me 280 milionë të vjetra tepër, ke të drejtë me absteni se ju nuk e pranoni këtë lloj gjëje.

-Ndue Luli: Vazhdojmë me pikën 8, projektvendim “Për miratimin e tavaneve të shpenzimeve sipas programeve buxhetore për PBA-në 2027-2029 (Faza e Parë) të Bashkisë Lezhë”.

Nga ana e bashkisë ka kush diçka në lidhje me projektvendimin? Zv/kryetaria e bashkisë e ka fjalën.

-Brikena Vuksani: Përshëndetje. Ky është një projektvendim i cili është në vazhdim të fazës së parë të projektbuxhetit 2027-2029, konkretisht është faza strategjike, ne kemi marrë dy vendime në këshill, njërin për miratimin e prioritetëve muajin e kaluar dhe miratimin për vlerësimin e të ardhurave, të cilat janë reflektuar te miratimi i tavaneve ku bëhet edhe krahasimi i tre viteve buxhetore faktike edhe miratimin e të gjitha shpenzimeve sipas çdo programi.

-Ndue Luli: Faleminderit. Kush e do fjalën tjetër? Nuk ka. Atëherë kush është dakord me projektvendimin? Miratohet me 29 vota Pro. Këshilltarja Donika Ndoj votoi Abstenim. Këshilltari Emanuel Perjaku nuk votoi. Faleminderit.

Kalojmë te pika 9, projektvendim “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 15, datë 29.02.2024 “Për miratimin e Programit të Transparencës në Bashkinë Lezhë””.

Ka kush ndonjë mendim në lidhje me projektvendimin? Nuk ka. Atëherë kush është dakord? Miratohet me 29 vota Pro. Këshilltarja Donika Ndoj votoi Abstenim. Këshilltari Emanuel Perjaku nuk votoi. Faleminderit.

Kalojmë te pika 10, informacion nga ASHK Lezhë për situatën e kërkesave të kalimit në pronësi, pa shpërblim, të tokës bujqësore.

Materialin që ka dërguar drejtorja e ASHK e ka secili këshilltar, mendoj që s'ka nevojë të lexohet por të kalojmë direkt në pyetje e diskutime. Fjala për zonjën Marku.

-Alfrida Marku: Faleminderit. Atëherë, si këshilltare, që në fakt e kam kërkuar thirrjen e ASHK-së në këtë mbledhje për të raportuar, mendoj që përveç pyetjeve kam edhe të drejtën e një komenti të relacionit që është depozituar. Së pari e vlerësoj faktin që kërkesa është marrë në konsideratë pas disa muajve vonesë në fakt sepse siç edhe e kam shprehur në mbledhjet e mëparshme janë të shumta ankesat e qytetarëve të Lezhës sa i përket vonësave të paarsyeshme për regjistrimin, për trajtimin e kërkesave të tyre për regjistrimin e tokës bujqësore të përfituar sipas ligjit 7501, por jo vetëm kaq, vonesat e paarsyeshme edhe në procesin e tejzgjatur të legalizimeve si edhe shërbimet administrative të tjera të përditshme për të cilat vë theksin se qytetarët paguajnë edhe tarifa të konsiderueshme. Paraprakisht unë dua të kujtoj faktin se e drejta e pronës është një e drejtë themelore kushtetuese dhe si e tillë askush nuk mund të pengohet në ushtrimin e kësaj të drejte dhe askujt nuk mund t'i mohohet e drejta e pronësisë, aq më tepër nga institucionet të cilat funksionojnë, në fakt duhet të funksionojnë sipas ligjit, si garant të të drejtave të qytetarëve.

E kam shqyrtuar relacionin e paraqitur nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës Drejtorja Vendore Lezhë, mbi situatën dhe elementët që ata pretendojnë si pengues për regjistrimin e tokës bujqësore nga përdorim në pronësi mbi bazën e akteve të marrjes së tokës në pronësi. Në relacion ASHK Drejtorja Vendore Lezhë trajton vetëm një zonë kadastrale ndërkohë që unë dua t'ju kujtoj këtu se ankesat e qytetarëve për vonesat e paarsyeshme të procesit të regjistrimit të tokës bujqësore janë nga të gjitha njësitë administrative të bashkisë Lezhë. Nga ana e ASHK Lezhë pretendohet mungesë bashkëpunimi dhe komunikimi me institucionet dhe i lidhin vonesat e trajtimit të kërkesave të qytetarëve për regjistrimin e tokës bujqësore me mungesën apo mosdorëzimin nga institucionet përgjegjëse të disa dokumenteve të tilla si skica fushore, libri i ngastrave, libër toke, lista e familjeve anëtare të ish-kooperativave bujqësore apo ish ndërmarrjeve bujqësore. Qytetarët e Lezhës nuk kanë nevojë për shpjegime por kanë nevojë për veprime dhe zgjidhje konkrete tashmë, mungesa e plotë apo e pjesshme e dokumentacionit burimor procedural të krijimit të AMTP-ve nuk është një zbulim i ri të nderuar përfaqësues të ASHK-së, është një fakt, është një realitet, që njihet botërisht prej më shumë se 30 vitesh tashmë, e mbi të gjitha vë theksin këtu, nuk është në mënyrë absolute përgjegjësi e qytetarëve. Mungesa e pjesshme apo e plotë e dokumentacionit burimor procedural është një fakt i njohur edhe nga praktika administrative por edhe gjyqësore në këto mbi 30 vite dhe pikërisht për këtë arsye duke iu referuar relacionit që ASHK Lezhë ka paraqitur, unë mendoj që ASHK nuk duhej të ishte

mjaftuar në një korrespondencë zyrtare pa product, por nga ana juaj i nderuar përfaqësues i ASHK-së duhet të kishte një nismë konkrete për zhvillimin e një tryeze ndërinstitucionale në nivel qarku si dhe të adresonit këtë situatë që vijon prej vitesh drejt autoriteteve vendimmarrëse qendrore. Të drejtosh një institucion nuk do të thotë të menaxhosh burimet njerëzore por të drejtosh një institucion do të thotë të identifikosh problematikat e qytetarëve, t'i njohësh ato dhe të dish t'i adresosh siç duhet dhe atje ku duhet, për të dhënë zgjidhje. Asnjë qytetar që disponon një akt marrje toke në pronësi të rregullt dhe që plotëson kriteret e një dokumenti zyrtar me fuqi të plotë provuese, që gëzon legjitimitet për t'u trajtuar me tokë bujqësore sipas ligjit 7501 në kohën kur është lëshuar akti i marrjes së tokës në pronësi, nuk mund të pengohet në të drejtën e pronësisë. Edhe ligji 20 i vitit 2020 në të cilin ju ndër të tjera keni referuar, në nenin shtatë të tij dhe jo vetëm, e parashikon qartë se akti i marrjes së tokës në pronësi regjistrohet kur plotëson kushtet formale dhe konfirmohet legjitimiteti i përfituesit, gjendja civile e 1 gushtit 1991, toka bujqësore e përfituar është pjesë e fondit të ndarjes së tokës, zëri kadastral tokë bujqësore si dhe respektimi i normës për frymë. Ndërkohë vë theksin këtu, verifikimi i thelluar në dokumentacionet burimore procedurale kërkohet sipas këtij ligji vetëm në rastet e mangësive formale në AMTP-në e paraqitur nga aplikanti. Mungesa e plotë apo e pjesshme e dokumentacionit burimor i cili nuk është përgjegjësi e qytetarëve nuk qëndron, pra pretendimi juaj në këtë rast nuk qëndron pasi në gjithë këto vite zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme më herët dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës sot, në mënyrë absolute nuk kanë mbajtur një standard të vetëm në trajtimin e kërkesave për regjistrimin e AMTP-ve të përfituara mbi ligjin 7501 për tokën dhe nëse mund të ma kundërshtoni këtë, mundeni, pse jo në këtë mbledhje. Përveç sa më lart, banorët e Lezhës me të drejtë shprehin ankesa edhe mbi vonesat tej çdo afati të arsyeshëm të trajtimit të kërkesave të përditshme të tyre për shërbime administrative të tilla që ju i njihni mire, si lëshim kartelet, lëshim apo korrigjim harte, korrigjim i të dhënave në dokumentin e pronësisë, ndarje apo bashkim i pronave, saktësim kufinjsh, kalim pronësie, fshirje i hipotekës kontraktore, e të tjerë, të cilët, e vë theksin sërish, pra, qytetarët, aplikantët paguajnë tarifa të konsiderueshme për këto shërbime që u ofrohen në tejkalim të çdo afati të arsyeshëm. Nëse ASHK-së, pra Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Drejtoria Vendore Lezhë, i duhet më shumë staf sikurse ju mes rrjeshtave e keni pretenduar në relacionin tuaj, çka në fakt nuk më duket e drejtë, ky nuk është problem i qytetarëve të Lezhës, nuk është e arsyeshme që ata të vuajnë këto pasoja, por është detyrë e juaja si drejtues i institucionit për të adresuar siç e thashë edhe më lart tek autoritetet vendimmarrëse qendrore tuajat. Për ta përmbyllur, unë me keqardhje e them, nuk e kufizoj në harkun kohor që ju drejtoni këtë institucion, nuk e kufizoj në as 12 as 10 as 16 vitet e fundit, për fatin e keq të gjithë shqiptarëve, jo vetëm të lezhjanëve, në këto mbi 30 vite, zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme më herët dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës sot, kanë qenë dhe janë institucionet që nuk i ofrojnë siguri juridike qytetarëve të Lezhës dhe të gjithë Shqipërisë sa i përket të drejtës së tyre të pronës, e cila siç edhe e thashë, është e drejtë themelore për çdo individ, jo pa shkak e mbrojtur edhe nga kushtetuta. Duke shfrytëzuar edhe këtë mbledhje të Këshillit Bashkiak, për ta përmbledhur, unë kërkoj nga ana juaj që të inicioni një tryezë ndërinstitucionale edhe me institucione të cilat ju i keni referuar në relacionin tuaj, ta adresoni tek autoritetet më të larta vendimmarrëse, për t'i dhënë fund njëherë e mirë penalizimit dhe pengimit të qytetarëve për të regjistruar tokën e tyre bujqësore të përfituar nga ligji 7501 për token. Unë dua t'ju kujtoj për analogji, çfarë u bë me vjetërsinë e punës që nuk njihej për shkak

të mungesës së plotë apo të pjesshme të dokumentacionit, apriori u njoh, iu dha fuqi e plotë provuese dokumentave që paraqesin qytetarët e në këtë linjë unë mendoj që sikurse dhe ligji e parashikon, ju duhet ta pranoni që një akt marrje i tokës në pronësi, që plotëson të gjitha kriteret e një dokumenti zyrtar me fuqi provuese dhe që aplikanti ka patur legjitimitetin për të përfituar token, duhet të mos vihet në diskutim, por të regjistrohet për t'i garantuar qytetarëve të drejtën e pronësisë. Faleminderit.

-Ndue Luli: Faleminderit. Fjalën e ka nënkryetari i Këshillit Bashkiak.

-Agostin Marku: Faleminderit. Unë e vlerësoj jashtëzakonisht shumë këtë thirrje të një institucioni shumë të rëndësishëm që ka të bëjë me ligjërimin e pronave por edhe menaxhimin e transferimin në subjekte të ndryshme. Vlerësoj edhe kërkesën por edhe përgjegjësinë e kryetarit të Këshillit që e ka sjellë në një kohë rekord në rendin e ditës, sepse ka të bëjë edhe me institucione shtetërore që në fakt nuk janë në varësi të Këshillit të Bashkisë dhe në një farë mënyre varet edhe nga predispozicioni i tyre dhe në këtë rast dua të falënderoj edhe drejtorin, i cili ka shprehur gatishmërinë, ka sjellë një material shumë serioz, me një përgjegjësi shumë të mirë, që rrallë herë ka ndodhur nga institucionet shtetërore në Këshillin e Bashkisë së Lezhës. Vlerësoj edhe punën e tij, që ka bërë gjatë kësaj periudhe që është vendosur si drejtues i këtij institucioni duke zgjidhur shumë problematika. Ne e dimë se në çfarë delikatese është edhe puna në këtë institucion, për arsye se merret me prona, por do të kërkoja që një vëmendje më e veçantë t'i kushtohet sidomos dosjeve të akumuluar të cilat janë diçka më tepër formale për të ligjëruar pronësinë e gjithsecilit qytetar që kanë të bëjnë me vendime të Këshillit të Ministrave të 25 apo 30 viteve, që kanë të bëjnë me shtëpi të trashëguara nga sistemi i kaluar, të cilat duan një miratim formal, duan shumë punë, por nuk kanë një përgjegjësi kushedi të çështja e zbatimit të ligjit, apo pse jo edhe asaj pune të filluar tashmë edhe nga bashkia por edhe nga vetë agjencia për sa i përket çështjes së ligjërimin, pra kalimit nga përdorim në pronësi të tokave të ish NB-ve. Urojmë që të njëjtën punë ta bëjmë edhe me institucione të tjera të rëndësishme që janë në shërbim të qytetarëve në territorin e Lezhës dhe qarkut Lezhë, ashtu siç po bëjmë me këtë drejtor. Faleminderit drejtor nga ana ime dhe urojmë që të kemi sukses të tillë në çështjen e analizës dhe kërkesës për përgjegjësitë në shërbim të qytetarëve dhe për institucione të tjera.

-Ndue Luli: Faleminderit. Një sqarim para se t'i jap fjalën drejtorit. Sa për dijeni, është e vërtetë kërkesa që është bërë nga këshilltarja Marku për këtë informacion nga ASHK-ja dhe duhet të them se nuk është shtyrja me disa muaj por është shtyrja me një muaj dhe shtyrja është bërë për arsye se Këshilli Bashkiak mujin e kaluar kishte një ngarkesë të madhe me projektvendime, informacione etj, kështu që besoj se është ajo fjala që tha dhe zoti Agostin për kohë rekord për të marrë informacion, e para. E dyta, kemi gjetur, atë që tha dhe zoti Marku, gadishmërinë e plotë të drejtorit në fjalë, se kemi edhe drejtorë të tjerë të cilët nuk e kanë pasur një gadishmëri të tillë. Përderisa punojnë në juridiksionin e Bashkisë Lezhë, përderisa punojnë për komunitetin tone, kanë të drejtë dhe detyrë të vijnë dhe të japin edhe informacione për problematikën të veçanta, kështu që faleminderit për këtë. Fjalën e ka drejtori i ASHK-së. (Ndërhyn zonja Ndoj duke thënë që të mbarojnë këshilltarët dhe pastaj të marrë fjalën drejtori) Dakord, dakord, zonja Ndoj e ka fjalën.

-Donika Ndoj: Po, atëherë në fakt, e drejta e pronësisë është një e drejtë kushtetuese, por sot qytetarët me të vërtetë kalojnë një kalvar vuajtjesh për të marrë të drejtën e pronësisë. Kjo për shkak ndoshta shpesh herë dhe të papërgjegjshmërisë edhe të sportelit aty, nganjëherë ndoshta dhe me etikën e komunikimit që përdorin juristët, nëpunësit që ndodhen aty. Kështu që për qytetarët e thjeshtë është shumë e vështirë që të marrin një certifikatë pronësie këtu. Ndërkohë që më parë mund të legalizosh një objekt shumëkatësh sesa një banesë njëkatëshe për të jetuar, apo edhe këto pritjet e gjata për qytetarët, saqë shpesh pazaret bëhen edhe nëpër lokale për të marrë ato certifikatat e pronësisë edhe për t'i përshpejtuar procedurat. Dhe këtë e thonë vetë qytetarët, sepse mbesin me vite pas dyerve të ASHK-së. Unë e them që duhet që ky institucion duhet të reflektojë për të pasur një proces të drejtë, të shpejtë dhe të barabartë për gjithë qytetarët, të ndiqet i njëjti standard për të gjithë qytetarët e thjeshtë, bëhet fjalë, dhe plus pastaj për ata pronarët e mëdhenj, që të trajtohen në të njëjtën mënyrë të gjithë. Kjo është ajo problematika që kërkojnë qytetarët e thjeshtë, të mos mbesin në dyert e kësaj agjencie shtetërore të kadastrës.

-Ndue Luli: Fjalën e ka kryetari i bashkisë.

-Pjerin Ndreu: Problemi është këtu që hiqni dorë të bëni politikë me akuza e me tymse, dakord? Çdo pretendim për legalizime të tilla duhet të adresohet te organet e drejtësisë, jo me letra anonime, por konkretisht. Bëhuni seriozë si politikë, po edhe si përfaqësues, se jeni votu. E nuk ju lejohet të ngreni insinuata e tymse Facebook-u këtu, se me Facebook-et tuaja jemi kënaqë duke i ba zi katran me bojë të gjithë. Këtu jemi në Lezhë dhe Lezha është e vogël. Nëse keni ndonjë gjë, e në qoftë se keni një pretendim, e në qoftë se keni një të dhënë, ju lutem adresohuni te organet e drejtësisë, jo me letra anonime, po me kallëzime direkte se kur, si, qysh dhe tek. Jo vetëm zyrat e kadastrës, po edhe zyrat e noterive që bëjnë zullume të tilla, dakord?

-Ndue Luli: Fjala për drejtorin e ASHK Lezhë.

-Altin Gjergji: Përshëndetje të gjithëve. Faleminderit për këtë interpelancë që më keni thirrë këtu. Do ta nis pikë së pari me zonjën në fjalë për pjesën e tokave bujqësore për ankesat që ka pasur në lidhje me parashtrimet që ka nxjerrë. Dua të theksoj diçka: ligji 20/2020 nuk është 7501 që citon zonja. Ligji 2020 është për pjesën e atyre që nuk janë trajtuar asnjëherë me AMTP dhe kanë paraqitur kërkesa, pavarësisht se janë legjitimu në aspektin e disa kriterëve ligjore, por që nuk janë trajtuar asnjëherë me AMTP. Dhe këto kërkesa konkretisht janë në disa zona specifike të cilat, për pamundësinë e pajisjes me fond të tokës në fshatrat ku kanë jetuar, i kanë dhënë një fond toke në zona të caktuara të cilat ua u kanë dhënë në përdorim. Pra, me këtë ligj ne po rregullojmë situatën që t'u jepet mundësia t'u kalojnë në pronësi. Kemi edhe diçka. Në raport me kërkesat, Bashkia Lezhë ka 600 kërkesa për t'u trajtuar me këto raste, të cilat janë me mangësi dokumentacioni për efektin jo se nuk i administron kadastra, apo se nuk i administrojnë qytetarët. Problemi është se është nisë në kohën kur ju i keni nxjerrë këto akte dhe i keni lënë qytetarët me një letër në dorë. As nuk i keni dhënë certifikata, as nuk i keni dhënë skica fushore, as u keni dhënë asnjë dokument. Veç u keni lënë një letër në dorë, u keni thënë: "E gëzofshi, kjo është toka juaj." As nuk keni shkuar për t'i përcaktuar kufinj të realisht se ku ndodhen ato pasuri, vetëm thjesht: "Jep letra edhe e gëzofsh." Për sa i përket shërbimeve të tjera kadastrale, në një hark kohor njëvjeçar, kadastra operon në rang qarku, jo vetëm në nivel bashkie. Sa për statistika, hajde i keni aty, 30.000 shërbime kadastrale janë operuar në harkun kohor të një viti. Në qoftë se

ke ndonjë ankesë, hajde shiko aty pas derës së ASHK-së, në gjatsh ndonjë qytetar, jua jap dorëheqjen këtu publikisht, para gjithë këshillit. Për sa i përket shërbimeve kadastrale, ke mundësi t'i kërkojsh agjencisë shtetërore të kadastrës evidencën në raport me aplikimet e prapambetura që ju po thoni nuk po marrin në kohë shërbim. Kadastra e Lezhës është e para në republikë për performancë në raport me kërkesat e qytetarëve dhe shërbimet në kohë reale që marrin. Unë nuk po them që nuk ka problematika, unë nuk po them që nuk kemi kohë. Po merremi me përmirësim përditësimin e gjithë zonës së qarkut Lezhë, po merremi me digjitalizimin e gjithë pronave të qarkut Lezhë. Jo më larg se natën e vitit të ri, juve zonjë keni qenë duke festuar dhe dashamirësit tanë këtu të qarkut Lezhë kanë dashur me i vu edhe flakën kadastrës për me djegë pronën tënde, time e të çdo qytetari.

-Ndue Luli: Të lutem, zoti drejtor, të lutem, të lutem, do të të ndërpres. Fol në parim ç'a të kesh me na informu ne si këshill, dhe nuk e kemi individuale këtë.

-Altin Gjergji: Jo, jo, nuk e kam individuale, e kam duke ia drejtuar zonjës për ankesat.

-Ndue Luli: Të lutem, shikoje me kujdes.

-Altin Gjergji: Jo, jo, më fal. Nuk ishte tek pjesa personale, nuk e kam personale me zonjën, sepse ajo parashtroi ankesat e qytetarëve dhe unë po parashtroj pjesën time.

-Ndue Luli: Jepni shpjegimet tuaja.

-Altin Gjergji: Dua të them edhe diçka tjetër. Jam i gatshëm të ftoj çdo qytetar të qarkut Lezhë, të cilët kanë ndërtuar shtëpi para vitit 2020 dhe në pamundësi për të vetëdeklaruar për arsye se janë jashtë shtetit ose nuk kanë pasur mundësi njerëz të adresohen drejt zyrave, të vijnë dhe të bëjnë kërkesë me shkrim dhe do t'i trajtojmë. Për sa i përket legalizimeve, besoj se në 2028 e mbyllim procesin e legalizimeve me objektet. Nuk ka diferencime as qytetarë, as biznese, as të majtë, as të djathtë. Ne jemi zyrë shërbimi, ne jemi në gatishmëri t'i shërbejmë çdo qytetari të qarkut Lezhë pa përjashtim.

-Ndue Luli: Zoti kryetar

-Pjerin Ndreu: Unë mirëkuptoj çdo lloj shqetësimi që vjen ndaj shërbimeve të ndryshme, pavarësisht se nuk është në varësi të bashkisë, por ligji 2020 është një problematikë që na afekton neve, bashkinë, se në fund të fundit gjithë procesi i dokumentacionit fillon në bashki, në njësitë administrative. Unë po ju them se fatkeqësisht për disa dhe fatmirësisht për gjithë opinionin publik, ne ngelim prapë bashkia më e mirë në avangardë në lidhje me ligjin 2020. Të tjerët s'kanë filluar fare, sa për dijeni, sepse ka një paqartësi shumë të madhe të dokumentacionit, edhe nga vetë aktet nënligjore që kanë dalë në zbatim të këtij ligji, të cilët kanë dashur me u sqaru, kanë ngecur, kanë dashur me u sqaru. Disa kanë marrë iniciativë, disa s'kanë marrë iniciativë, ne e kemi marrë iniciativën. Janë 60 dhe 50 që dalin këto ditë dhe ne jemi duke e ndjekur procesin, por ka edhe një problem që ne e kemi hasur që janë këto: jo janë jashtë shteti, jo nuk vijnë, jo nuk bëhen. I kemi marrë në telefon, thirri hajde aman, tërhiqi për bluze, nuk është ashtu si mendohet. Disa nuk kanë dokumentacionin përkatës. Nëse s'ke dokumentacionin përkatës, normalisht që këto dokumente burimore që thoni ju, nëse s'janë, ligji parashikon që duhet të jenë. Nëse s'janë, ai nuk vepron dot. Pra, kjo nuk është një histori që i duhet ra

kadastrës. Tani, dalim te pjesa tjetër. A është kadastra një zyrë që duhet të përmirësohet në shërbim? Po, po ta them unë, po. Unë i pari, më ka qëlluar disa herë me ndërhy vetë për ndonjë sjellje jo të mirë të ndonjë punonjësi aty, që më ka ardhur qytetari dhe ia kam thënë drejtorit. Drejtori e ka marrë, edhe drejtorët që kanë qenë, e ka marrë në dorë dhe e ka rikuperuar. Ne nuk mund të themi se ka perfeksion, në fund të fundit bijtë e bijat tona punojnë aty dhe janë të gjithë të rinj. Se meqë ra fjala, unë jam me i vjetri në bashki aty, unë e Marte Feta. Të tjerët janë të gjithë të rinj, Të gjithë stafin e kam të ri. Ca i kam gjetur, njërin nënkryetare e kam gjetur aty. Tjetri është komplet i ri, tjetra është e re. Gjithë stafi tjetër i drejtorëve është relativisht i ri. Normalisht që mund të ketë mungesë përvoja administrative, edhe ASHK-ja, edhe bashkia, edhe një institucion tjetër. Ne jemi duke u përpjekë që ta përmirësojmë. Ju nuk e dini një gjë që, për shembull, bashkia njëherë në 10 ditë jep një përgjigje të një ankese të një qytetari, dhe ditën e hënë drejtorët e mi, që meqë po hyjmë në këtë komunikimin publik, japin llogari ditën e hënë para meje këtu, se pse ka kaluar 10 ditë pa i dhënë përgjigje ankesës apo kërkesës. Jemi e vetnija bashki në Shqipëri që e bën këtë, për 10 ditë. Këta kanë një specifikë tjetër. Jo çdo ankese qytetari, çdo shqetësim qytetari është e drejtë, se ne na vijnë përditë. Pra, unë ju inkurajoj ju, personalisht si kryetar bashkie, gjithë këshillin bashkiak, që të merret me shqetësime të ndryshme të qytetarëve që jo kanë të bëjnë vetëm me bashkinë, por edhe me çdo institucion tjetër. Ne mund të hyjmë në rolin e interlokuesit, edhe me kadastrën, edhe me spitalin në qoftë se nuk funksionon, edhe me OSHE-në. Pse jo? Sepse në fund të fundit ju jeni përfaqësues të qytetarëve. Unë ju inkurajoj që t'i merrni ata, po jo me idenë se i morëm dhe aty po bëhet një hata e madhe dhe ne tashti prit ta shohim se çfarë do zbulojmë ndonjë gjë të madhe. Janë djemtë e vajzat tona aty që punojnë prej mëngjesi e deri në darkë dhe punojnë shumë. Ndoshta nganjëherë nuk ia dalin, por me u bë qejfin të gjithëve. Në shtëpitë tona s'e besoj se ia keni dalë ndonjëri për me qenë të gjithë rehat e me shku rehat në shtëpi në darkë. Tash edhe ne e kemi problem. Por kadastra duhet të jetë më e zhdërvjellët. Mua më kanë thënë që muajin që kaloi ka qenë më e mira në Shqipëri. Kështu më është raportuar. Uroj të ecin si duhet, por për të përmirësuar ka. Atë 2020 po e ndjekim ne dhe është shqetësim tamam, po e ndjekim. Dalin nja 50 tashti, por është shumë vështirë se janë toka në përdorim.

-Altin Gjergji: Është edhe diçka, ne na pengon dhe qendra kombëtare e digjitalizimit, sepse duhet t'i nënshtrohet se s'bën një përmirësim përditësimit të zonës që nuk është në varësi tonën.

-Pjerin Ndreu: Kam shkuar tre herë unë atje. Është e vërtetë. Ajo ka qenë mbivendosja, është digjitalizuar komplet sistemi i vendosjes se ka pasur mbivendosje, mosmarrje vesh se kush është kjo, kush është ajo. Biles, me sa di unë, Lezha është ndër të parat që e ka kryer këtë proces aty.

-Altin Gjergji: Lezha ka kryer gjashtë blloqe kadastrale, janë edhe gjashtë të tjera që presim. Në momentin që ata vijnë si blloqe kadastrale nga qendra kombëtare e digjitalizimit, ne operojmë me listën për t'ia u sjellë në këshill për t'i paraqitur me vendim.

-Ndue Luli: Qartë. Fjalën e ka zonja Gjoni.

-Flutura Gjoni: Pothuajse u ezaurua por materiali që na ka ardhur është 32 faqe. Nga 1-9 lexohet shumë mirë, 9- 14 diçka, nga 14 e mbrapa s'lexohet hiç.

-Altin Gjergji: Ajo është një kopje e shkresës që është bashkëlidhë për informacion në lidhje me kërkesat që i kemi bërë në këshillin e qarkut për të na vënë në dispozicion dokumentacionin që ne nuk e administrojmë.

-Ndue Luli: Zonja Marku.

-Alfrida Marku: Një koment shtesë në vijimësi të asaj që u diskutua. Nuk më vjen mirë në fakt që e trajtoni emocionalisht, pra përfshiheni jo në mënyrën e duhur për të trajtuar këtë çështje. Ky është këshilli bashkiak, është i vetmi organ kolegjal përfaqësues i qytetarëve të bashkisë Lezhë, të 10 njësive administrative, dhe unë ju inkurajoj që ju, si drejtues, ta vlerësoni, pse jo të nxisni llogaridhënien, sepse ajo për të cilën ne ju kemi ftuar në këtë mbledhje të këshillit bashkiak është që të marrim dijeni, të adresojmë si fillim problematikat e qytetarëve dhe të marrim dijeni mbi ato pretendime që ju mund të ngrini në lidhje me pamundësitë e veprimit nga ana juaj. Unë dua të kujtoj vetëm një fakt, se u pretendua këtu që vepronin kohë. Jo, nuk është e vërtetë që vepronin kohë dhe kjo nuk është ajo që them unë, por është diçka që dihet nga qytetarët. Në fillim të vitit të kaluar, këtu në këshill bashkiak u diskutua, madje është edhe zoti Shtjefni këtu, se sa praktika të iniciuara dhe plotësuara nga bashkia e Lezhës të përcjella institucionit tuaj për regjistrimin e pronës mbi bazën e AMTP-ve nga përdorim në pronësi janë pezull pranë ASHK-së. Dhe këtu, e një vit përpara, zoti Shtjefni e deklaroi publikisht që janë rreth 800 praktika pezull, që do të thotë 800 familje. Ju mund të pretendoni se këta qytetarë nuk vijnë, siç e keni shkruar aty, nuk vijnë në terren apo nuk vijnë për t'u paraqitur për të marrë dokumentin. Unë kam dyshime në këtë pretendim, sepse sa kohë unë si qytetar paraqitem pranë bashkisë Lezhë për të plotësuar një praktikë, absolutisht që interesin për të fituar të drejtën time legjitime e kam aq më tepër kur dosja shkon në ASHK. Merreni si sugjerim, sepse kritikën nuk lidhen me individin. Sugjerimet edhe ballafaqimi i problematikave që shprehin qytetarët lidhen me institucionin. Merreni si sugjerim me qëllim që t'i shërbeni banorëve të Lezhës ashtu siç e meritojnë. Ju thatë në fillim të fjalës tuaj që në kohën tuaj u dhatë përfituesve nga një copë letër pa arkiva bashkangjitur. Në qoftë se u treguti i vëmendshëm, unë u shpreha qartë: në këto 30 vite është abuzuar jashtëzakonisht me qytetarët, jo vetëm të Lezhës, por edhe të gjithë Shqipërisë sa i përket të drejtës së pronës. Dhe ju, sa kohë e konstatooni mungesën plotësisht apo të pjesshme të dokumentacionit, asgjë nuk ju pengon që, siç edhe e thashë, të inicioni një tryezë ndër-institucionale në nivel qarku dhe të adresoni një zgjidhje përfundimtare për t'i dhënë fund këtyre ecejakeve të qytetarëve. Kryetari i bashkisë e tha që në institucionin që unë drejtoj, maksimalisht brenda 10 ditëve trajtohet një kërkesë apo ankesë e qytetarëve. Unë di raste që për procedura të përditshme administrative, për shërbime administrative të përditshme që qytetarët adresojnë pranë ASHK-së, drejtoria vendore Lezhë, edhe në ato raste që ligji parashikon procedurën e përshpejtuar, që do të thotë tarifa që ata paguajnë është më e lartë, vonesat janë përtej çdo afati të arsyeshëm. Kështu që unë ju sugjeroj, unë kërkoj nga ana juaj që në emër të interesit publik që duhet të na ulë kokën gjithsecilit prej nesh që jemi këtu dhe të mos ngremë zërin kur diskutojmë me njëri-tjetrin, në emër të institucionit publik, të reflektojmë dhe t'i japim banorëve të Lezhës shërbimin që ata meritojnë. Faleminderit.

-Pjerin Ndreu: Një sugjerim kam unë me këtë rast që t'i vëmë pikat mbi i. Unë jam dakord plotësisht me shqetësimin, por pse nuk e merrni e me shku vetë për rastet me cilësinë e anëtarit të

këshillit të bashkiak te zyra X përkatëse e drejtorit dhe më i thënë problemin. Më ka ndodhur mua që ndryshe më ka thënë qytetari, ndryshe më ka dalë situata atje. Pra, jo të gjithë e kanë të justifikuar atë panikun e madh që bëjnë, sepse vjen tjetri pa asnjë letër e thotë: "Ti je Zoti, kryetari i bashkisë, me i thënë ti atij, ai e bën nesër." Shkoni, s'ka rëndësi se kush këshilltar je, s'ka rëndësi i cilës parti je, ka rëndësi se një qytetar X ka një shqetësim. Merreni në telefon, shkojini dhe i thoni: "O zotëri, këtij qytetari i është vonu, nuk i është dhënë e drejta." Pse mos ta bëjmë këtë? Se në qoftë se e marrim vetëm të keqen dhe normalisht unë nuk jam kundër asaj që thoni ju, se në administratë të shtetit nuk funksionon gjithçka ashtu sikur duhet. Nëse do me gjetë anë negative të të sjellurit, të dhënies së shërbimit ka sa të duash, por ne çfarë detyre kemi? Ne e kemi vullnetin e mirë këtu në këshill që të gjithë bashkë ta adresojmë gjënë, jo ta bëjmë këtu si alibi për me nxi njërin e tjetrin, sepse në fund të fundit këtë qëllim kemi ne, për t'i shërbyer njerëzve. Hajde të hyjmë të gjithë në lojë. Nuk e bën ky, hyj unë në lojë, hyn tjetri, hyn tjetri dhe ne të zgjidhim problemin e qytetarit. Ky nuk është problem politik, ky është problem standard administrativ që ti je i detyruar për sa kohë drejton një institucion dhe nga ana administrative ti je i detyruar me iu përgjigjë qytetarit pikë së pari. Pikë. Dhe qytetari ka të drejtë me marrë një përgjigje. Ka plot raste, për shembull, në bashki ku përgjigjja nuk u pëlqen. "Shif çfarë përgjigje më kanë sjellë." Ne e çojmë me shkrim përgjigjen. Kur është negative, e çojmë me shkrim, nuk përfiton për shkak të kësaj, të kësaj dhe ka një referencë ligjore ku i referohet secila nga drejtoritë, ka një shpjegim shterrues që unë nuk mund të ndërhyj. Ka plot njerëz që nuk e kuptojnë këtë gjë. Ka njerëz që kujtojnë se të vish te kryetari i bashkisë apo të shkosh te drejtori, ti do ta zgjidhësh patjetër, pavarësisht se ka apo s'ka të drejtë, pavarësisht se ka apo s'ka letra, pavarësisht se i takon apo s'i takon. Jemi përballë këtij fenomeni. Ju e keni hasur kur keni punuar aty. Të gjithë e hasim. Këta që pretendojnë, kur të vijnë mbas ca kohësh do ta hasin, se kështu do shkojë kjo punë. Pra, ne jemi përballë njerëzve tanë. Kaq është Lezha. Ne duhet ta adresojmë gjënë.

-Alfrida Marku: Ato dosjet që janë pezull, që janë përcjellë nga bashkia në ASHK, a mund ta ndjekim ne një grup këshilltarësh?

-Pjerin Ndreu: Po patjetër, çfarë problemi ka? Madje na ndihmojnë. Ka të paktën një vit që ne diskutojmë për këtë problemin e tokave në përdorim të 2020-ës. Unë po ju them, ka bashki që nuk e kanë prekë me dorë, se ka një paqartësi të interpretimit në praktikë të kësaj. Ne e kemi marrë iniciativën, kemi lëvizë. Ka qenë dhe problemi i digjitalizimit, se nuk merrej vesh se ku është ndarja, ku mbivendosje. ASHK-ja po e bën këtë proces me blloqe, dhe ne na lehtëson pastaj që të jemi të qartë se ku, se jemi marrë intensivisht me këtë punë edhe ne si bashki, por edhe njerëzit janë indiferentë. Nikolini ndoshta di pak më shumë për këtë punë, se është drejtori përkatës në bashki.

-Ndue Luli: Zoti Nikolin, po.

-Nikolin Shtjefni: Atëherë, duke parë dhe nga eksperiencia e përditshme që ne kemi, jo më larg se dje paradite, unë kisha një çift të moshuarish që kishin bërë një kërkesë dhe kërkesa ishte thjesht një kopje e AMTP-së. Dhe gjatë diskutimeve që ne bëmë aty, rezultoi që në certifikatën e 1 gusht 91-shit, që është kushti kryesor për të qenë përfitues i AMTP-së, në atë kohë kishte qenë dhe kunati. Dhe sot, ata pas 20 e ca vitesh kishin prishur marrëdhëniet dhe nuk i interesonte më

që t'i bënte këto regjistrime të AMTP-ve. Pra, nga momenti që ti ke marrë AMTP-në me sot, ka ndryshuar rrjedhoja e familjeve dhe shpesh herë kërkesat nuk janë të qarta. Pra, vetë vetvetiu i sjellin me mangësi, që do të thotë, ne i plotësojmë dokumentet në kohë reale, por shpesh herë qytetarët nuk duan t'i plotësojnë, thotë: "Kjo është toka ime, është toka që ma ka lënë i pari im," por ne funksionojmë në bazë të ligjit, nuk funksionojmë në bazë të kanunit. Këtë ma ka lënë gjyshi dhe do ta gëzoj. Për sa i përket ASHK-së, kanë një përgjegjësi ata pastaj për çdo veprim që ndër marrin. Pra, pavarësisht dëshirës që mund të kenë për të kryer një veprim, në qoftë se shkojnë në paligjshmëri, nesër pasnesër duhet të parashtrijmë para ligjit pse ke vepruar kështu. Pra, ne jemi të detyruar me marrë kohën tonë, me kry veprimet sipas ligjit dhe me kry veprimet. Domethënë, me sa kam pa unë, të paktën nga 10 vitet e fundit që janë kryer veprime nga kalimi i tokës në përdorim në pronësi, ne i kemi bërë në kohë rekord. Çdo tapi që ka ardhur për të kaluar në këshill, ne e kemi bërë në kohë rekord. Por ne nuk mund të bëjmë veprime të paligjshme, që do të thotë, veprimi i paligjshëm do të thotë që në qoftë se ASHK-ja ka kërkuar kohën për të bërë përmirësim përditësimin e pronave, nuk mund ta kesh tokën këtu nga ana juridike dhe nga ana e hartës ta kesh diku tjetër, siç është. Po të shikosh krejt zona e ishullit, tokën e ke diku në kartelë, ndërsa në hartë e ke diku tjetër. Për të gjitha ato 800 dosjet, është bërë përmirësim përditësimi i hartës.

-Altin Gjergji: Të lutem, janë 800 kërkesa, jo dosje. Janë 800 kërkesa të cilat kanë bërë vetëm një kërkesë me shkrim brenda afatit ligjor që ka qenë në mars të 2020-ës deri në shtator tetor. Janë vetëm kërkesa e nderuar. Dokumentacionin po e plotësojmë ne, shqyrtimin po e marrim ne dhe ne na duhet ndihma e qytetarëve dhe institucioneve përkatëse për të administruar të gjithë dokumentacionin ligjor për të cilat janë të përcaktuar në VKM, të cilat ne jua sjellim ju në këshill dhe ju miratoni listën për të dalë ne me vendim.

-Nikolin Shtjefni: Dhe po s'u plotësu dokumentacioni, ne nuk mund t'i bëjmë në mënyrë të njëanshme, pavarësisht dëshirës që kemi që t'i mbarojmë.

-Ndue Luli: Besoj se ishin shterruese sqarimet, kështu që fjalën e ka zoti Ndreca.

-Erin Ndreca: Që të mos zgjatem, në këtë këshill janë vendosur dy standarde. E para është prania e kryetarit të bashkisë në çdo mbledhje dhe e dyta është pjesëmarrja e disa drejtuesve të institucioneve që i kemi kërkuar dhe pa dyshim që meritë është dhe e këshilltares Marku. Por doja të thoja që këto standarde, meqë i kemi arritur, mos t'i ulim duke komentuar nivelet emocionale të askujt, sepse nuk jemi psikologë. Mbase dikush ashtu ka intonacionin e zërit dhe gjithmonë kam qenë i parimit që të ngrejme problematika, shqetësime, por jo më thanë dhe ju thashë. Dua t'ju ndaj një përvojë timen. Duke ardhur këtu, takova drejtorin e ASHK-së jashtë, nuk kam asgjë që ta mbroj, dhe një qytetar i Lezhës ndaloi dhe e takoi dhe e falenderoi për zemërsisht për shërbimin e shpejtë që kish marrë në kohë reale dhe pa bërë asnjë pagesë jashtë atyre ligjore. Prandaj mendoj që të gjitha kanë vend, por që të mos kalojmë me shembuj. Ato që janë ligjore, janë ligjore dhe të përmirësohen. Faleminderit.

-Ndue Luli: Faleminderit. Zoti Marku.

-Gjon Marku: Faleminderit kryetar. E tërheq diskutimin sepse u ezaurua.

-Ndue Luli: Po, zoti Jaku.

-Dod Jaku: Përshëndetje të gjithëve. Faleminderit. Shumë probleme dolën. E dimë që problemi i pronësisë është problemi më i ndjeshëm dhe ankime e shqetësime ka nga shumë qytetarë, jo vetëm Lezha, por gjithë Shqipëria. Unë kam shumë rezerva, nuk është vendi për të folur për këtë drejtim. Unë kam një mendim në lidhje me këto që po diskutojmë për personat që kanë tokën në përdorim dhe për kthimin në pronësi, jo vetëm ne si njësia e Shënkollit, po besoj se gjithë Lezha, po ne jemi me shumicën e problemeve, sepse është njësia më me peshë që ka pasur tokë në përdorim dhe po kthehet në pronësi. Unë falenderoj kryetarin e bashkisë këtu që është interesuar vazhdimisht, vit pas viti, për t'u bërë mbështetje e kësaj pune, por problemi i kadastrës më vjen keq, por është për të dëshiruar. Këto kohët e fundit kam filluar të dëgjoj fjalë të mira dhe e përgëzoj drejtorin e ri që ka ardhur, por edhe kur unë kam qenë drejtues i drejtorisë së bujqësisë, kemi pasur probleme të pafundme të cilat i kemi hasur. Pa u zgjat në këtë diskutim, më shumë kam një mendim. Nëse është e mundur drejtoria e kadastrës dhe e hipotekës Lezhë, në bashkëpunim me institucionet, e përsëriti dhe zonja Alfrida, por kryesisht me kryepileqtë dhe me punonjësit e njësive administrative që mbulojnë këtë sektor, të bëjnë disa trajnime e disa njohje ligjore që t'i ndihmojnë njerëzit të mos të jenë t'u u sjellë rrugëve, sepse ka shumë, shumë paqartësi. Unë këto praktika i has shpesh në fshatin tim ku banoj, sepse kanë qenë mbi 200 familje që i vuajnë këto probleme dhe ka paqartësi të pafundme. Pra, ligji 2020, është e vërtetë ajo që tha kryetari, që edhe e dimë, një pjesë e dimë, po qytetarët nuk e dinë shumica këtë problem.

Mendimi im është ky: për t'u ardhë në ndihmë sa më shumë qytetarëve, hipoteka bashkë me kadastrën, specialistët që i kanë aty, t'i mbledhin dhe të bëjnë disa instruktive dhe disa informime që njerëzit ta marrin shërbimin në fshat, ta marrin shërbimin në njësi, dhe pastaj të vijne edhe t'u zënë dyert këtyre në hipotekë dhe në kadastrë. Faleminderit.

-Ndue Luli: Faleminderit. Atëherë, e mbyllim informacionin me ASHK-në, duke e falenderuar edhe njëherë për gatishmërinë që ka pasur për të ardhur dhe për të raportuar në lidhje me punën që bëhet atje.

Kalojmë te pika tjetër: raport për veprimtarinë e Këshillit të Bashkisë Lezhë për vitin 2025. Materiali për raportin ka qenë në duart e secilit. Besoj do e keni parë, por megjithatë, gjatë vitit 2025, siç e dini, janë marrë 124 vendime, ka patur angazhime të mëdha nga ana e këshillit për problematika të ndryshme të cilat kanë të bëjnë me ligjin "Për Vetëqeverisjen Vendore", por duhet të theksojmë se kemi akoma për të bërë në lidhje me angazhimin e çdo këshilltari, jo të një mase të madhe, por të secilit prej nesh, në problematikat që na takojnë secilit për t'i kryer në zbatim të ligjit. Kush ka diçka në lidhje me raportin që mund të bëjë, ndonjë pyetje, ndonjë sugjerim, është i mirëpritur. S'ka.

Atëherë, kalojmë te pika fundit: "Të ndryshme". Fjala për zonjën Marku.

-Alfrida Marku: Dy problematika. Nga shumë qytetarë më është kërkuar që ta parashtroj në mbledhjen e këshillit që për shkak të punimeve që po bëhen për rrjetin e kanalizimeve në qytet, të ndërhyhet nga bashkia Lezhë me staf të policisë bashkiake për menaxhimin e trafikut në ato pika që krijohet mbingarkesë. Janë pikërisht ato zona ku po bëhen edhe ndërhyrjet më të mëdha.

Gjithashtu, edhe një tjetër shqetësim që lidhet me këtë, pra është pasojë edhe e punimeve. Qytetarët kërkojnë që të jenë pak më mirëkuptues policia bashkiake dhe policia e shtetit kur vjen puna për të vendosur ato gjobat për parkim të gabum. Kjo është çështja, problematika e parë. Problematika e dytë që në fillim të mbledhjes nuk u trajtu në fakt siç është, sepse është mirë kur shtrojmë problemet ta njohim situatën, por e lashë që ta diskutoj në këtë moment. E kam diskutuar dhe në mbledhjen paraardhëse. Janë disa familje në lagjen Skënderbeg. Ua kam parashtruar edhe nënkryetarëve në mbledhjen e muajit shkurt, pallati 16 quhet ai. Ai është konstatu i pabanueshëm që në vitin 2008. Kuptohet që amortizimi për shkak të kohës, shtu këtu edhe ndikimin e tërmetit të 2019-s, e kanë agravuar akoma më shumë situatën e këtij objekti. Janë dy familje ndër të tjera që jetojnë në këtë objekt, edhe me kërkesë të tyre, unë mendoj dhe e parashtroj në këshill që këto familjet të thirren apo të kontaktohen nga bashkia Lezhë me qëllim që deri në gjetjen e një zgjidhje të duhur për situatën e tyre, të përfshihen në skemën e bonusit të qerasë. Gjithashtu, ata kërkojnë që të kenë lehtësi edhe sa i përket në një fazë më të avancuar për lejet e ndërtimit, nëse ata krijojnë apo kanë mundësitë financiare për të ndërtu diçka me iniciativë të tyre. Por pse jo, ai objekt, ai truall të kihet parasysht nga ana e bashkisë Lezhë për ndonjë objekt të mundshëm që mund të ndërtohet, pse jo, me qëllim zgjidhjen e strehimit për familjet që janë në nevojë, ku të zgjidhet edhe strehimi i këtyre banorëve që disponojnë dokument pronësie në këtë pallat. Faleminderit.

-Pjerin Ndreu: Meqenëse dolët te kjo tema e punimeve, ne e kemi paralajmëruar këtë histori. Normalisht, kjo rrëmujë është e bezdisshme, sepse janë punime në mes të qytetit dhe ne nuk kemi si me i ngritë në ajër. Kuptohet, po ta hapësh edhe faqen e bashkisë, e gjithë share-t që bëjmë ne, nuk kemi lënë rast kur s'kemi thënë do bllokohet këtu, do bëhet kjo shigjeta, se kam pa dhe nga këto aktorët e turbullum gjoja të shoqërisë civile që tregojnë ca përralla që jo s'është e s'bën e ka sinjalistikë firma për atë punë, policia bashkiake ka ndejt aty. Po, jam dakord me atë problematikë të penalizimit, jam dakord. Unë ia kam thënë dhe policisë së shtetit, që për sa kohë jemi në punime, ne u kemi kërkuar publikisht edhe qytetarëve që mos t'i përdorin makinat. Dhe unë kam dalë në këmbë, kam ikur në shtëpi disa herë vetë për shkak të pamundësisë me hy. Unë njëherë te pallati im kam vështirësi me hy sot me makinë. Normalisht, qyteti është në punime. Këto janë punimet më të rëndësishme që mund t'i ndodhin Lezhës ndonjëherë. Lezha, nëse ka një shenjë të rëndësishme zhvillimi në eliminimin e dy problematikave madhore që janë ujërat e zeza dhe ujërat e bardha, përmbytja që më çojnë mua foto. Pavarësisht se ne jemi në proces dhe ky proces është me gjermanë, me supervisor gjerman. Këto nuk bëhen me shpejtësi, sepse supervisor gjerman nuk e len investimin me shku oburra. Pra, nuk është në stilin tonë kjo punë dhe ne që të jemi realist, ne po vijmë sot që flasim, ne po vijmë paralel me 43 rrugë urbane brenda qytetit dhe kemi filluar te lagjja frutore. Kemi hyrë në lagjen Skënderbeg, po bëhet gati për asfalt edhe rruga demokracia te lagjja e fiqve që i themi ne. Do hyjmë në lagjen "Nënë Tereza" komplet. Unë kam biseduar me firmën, ore na lini të hyjmë, sepse kam dëgjuar dhe nga këto shkencëtarët e mëdhenj që thonë e hapën kanal, po nesër duhet t'i vihet asfalt. Po si u vika asfalt? Ai duhet të flejë, ai ka periudhën e vet të fjetjes njëherë se duhet të ngjeshet në mënyrë natyrale, plus ngjeshjet që do i bëjnë në fund, për me e shtru asfaltin. Nëse sot ata na lënë hapësirën, ne shkojmë me asfalt. E kemi gati. Nuk është puna se po e prokurojmë e po mendohemi. Këtu në këshill e kemi bërë. Janë të prokurume. Ka filluar puna, po po vijmë nga periferia. Në lagjen e spitalit, asnjë shenjë nuk e kena ba atje në vite për shkak të këtij investimi.

Normalisht që do ecim në rrugë të prishme, do ketë edhe problematikë në lëvizjen e njerëzve, do ketë problematikë edhe me çuarjen e fëmijëve në çerdhe e në kopsht, po është gjendje e përkohshme. Është një, domethënë, grricje nervash pozitive, shyqyr që erdhi një ditë që ta mbyllim qytetin poshtë dhe mos të shohim më sa bie një orë shi. Investim si ky, shumë qytete nuk e kanë, nuk ka shans si ky në Shqipëri. Të kësaj cilësie nuk e kanë jo. Unë po ju them edhe njëherë publikisht ju që të bëheni zëdhënës të çtensionimit të problematikës së njerëzve, se nuk kemi çfarë t'i bëjmë.

-Ndue Luli: Zoti Gjinkola.

-Pjeter Gjinkola: Përshëndetje të gjithë. Ka filluar një fenomen në qytetin e Shëngjinit nga ana e policisë, duke prerë gjoba edhe në rrugë dytësore, që ndodhen disa vija të verdha, ku vija e verdhë mund të jetë edhe sipër trotuareve.

Dhe një pyetje kam për drejtuesit e bashkisë: Pse Shëngjini si qytet, me të njëjtat pozita që ka bashkia e Lezhës, pavarësisht se nuk është qendra e rrethit, por qytet është edhe ai, pse mos të jetë i monitoruar nga policia bashkiake 12 muajt e vitit?

-Pjerin Ndreu: E para, ne nuk mund t'i themi policisë së shtetit: ik nga territori. Ajo që duhet të bëni ju si banorë, duhet të bëni një petition ankesë te policia e shtetit, merrni edhe median, merr edhe këshilltarët dhe denonconi çdo lloj veprimi të paligjshëm që mund të bëjë policia në penalizimin e njerëzve atje.

M'u kujtu një gjë për erozionin. Është një grup kinez ndër më të mirët në botë që do vijnë për të bërë një studim për Kunen dhe kryeministri i ka sjellë, më ka thënë që do merren me Kunen, me një zgjidhje.

-Ndue Luli: Zoti Trashaj, pastaj zoti Artan.

-Alfons Trashaj: Kryetar, një shqetësim i banorëve është emërtimi i rrugëve dhe adresave.

-Pjerin Ndreu: Bëjeni, bëni një grup atje me banorët. E kemi diskutuar disa herë këtu, edhe në bashki kam thënë, merruni, se nuk është detyra ime ajo. Ne mund t'i emërtojmë, për shembull, unë mund ta bëj rruga Pekini ty. Po se e ka bërë një kryetar bashkie,

-Alfons Trashaj: Kam folur me administratorin disa herë dhe nuk më është përgjigjë.

-Pjerin Ndreu: Mblidhuni por dua 70% të firmave. Kur të më bësh 70% të firmave të banorëve që propozojnë që propozojnë për një rrugë, ju si këshilltarë e miratoni, se s'i miratoj unë. Unë jam dakord, thjesht ju thoni po, dakord.

-Alfons Trashaj: Një shqetësim tjetër i banorëve janë furgonat që vijnë nga rrethet dhe shesin pranë marketeve që janë tatimpagues të Bashkisë Lezhë. Vijnë edhe orar pa orar me altoparlant.

-Pjerin Ndreu: Denoncojini, telefon, policia e bashkiave direkt vjen menjëherë.

-Alfons Trashaj: Dhe një shqetësim tjetër i banorëve është që rruga që ke bërë e reja ka dy-tre pika që po prishet, rruga që shkon te kisha.

-Pjerin Ndreu: Të vijë firma, është në garanci, se s'i ka marrë lekët akoma, nuk është marrë në dorëzim akoma.

Ne në po them mbi 95% të rrugën nuk kemi pasur problem, por ndoshta për shkak të terrenit të thyer aty, mund të ketë pësuar ndonjë gërryerje.

-Ndue Luli: Zoti Artan e ka fjalën.

-Artan Ndreu: Përshëndetje të gjithëve. Zoti kryetar, unë kam një kërkesë për ty edhe për deputetë të Lezhës për dy marsin që të bëhet festë kombëtare. Ne kena shumë festa zyrtare, por ditën më të rëndësishme të kombit shqiptar, 2 Marsin, nuk e kena.

-Pjerin Ndreu: Do ta kemi patjetër.

-Ndue Luli: Zoti kryetar, dy gjëra të shkurtra fare kam unë nga mendimet e disa banorëve. Bëhet fjalë për stacionin e furgonëve të Ura e Cenit, ku janë kompani të licencuara të cilat kanë ankesë për ndalimin e makinave të tjera të cilat s'kanë licencë fare, në një kohë që ato paguajnë taksat, e para. Dhe e dyta, te lulishtja te lagjja e Drinit, pasi si rezultat i mangësisë së parkimeve që ka sot për sot qyteti, si rezultat i punimeve që po bëhen, kanë filluar parkimet në atë lulishten, apo si me thënë, në atë pjesën publike, ku duke qenë se ka edhe makina të rënda, po bëjnë dëm aty. Janë ankesat e banorëve. Këto dy ankesa kam unë nga banorët. E treta që kam në lidhje me atë që propozoi këshilltari Trashaj për emërtimet e rrugëve, meqënëse një pjesë e këshilltarëve është këtu, në të gjitha zonat, ose më saktë në të gjitha njësitë administrative, duhet të vijnë kërkesa për emërtim rrugësh nëpërmjet njësisë administrative. Pra, do të thotë që lagjja X apo rruga në fshatin X, i bëhet kërkesa njësisë administrative me gjithë ato firma që tha dhe kryetari, shumë drejtë, dhe njësia administrative e dërgon te këshilli bashkiak, sepse na ka dalë një problem në vitet e kaluara që duke ardhur edhe te ne drejtpërsëdrejti, ka patur ndoshta edhe firma falco, po e themi hapur këtë, kështu që ato do të verifikohen edhe nga ana e këshillit, por duke ardhur nëpërmjet njësisë, kryetari i njësisë i shikon mirë kush është filani, është banori i kësaj lagjeje apo s'është, kontrollohen më saktë. Faleminderit.

-Pjerin Ndreu: Ato furgonat do t'i heqim fare prej aty, do t'i gjejmë vendin, vend të përcaktuar. Ata janë ndotësit më të mëdhenj dhe sjellësit më negativ me ambientin, furgonat. Domethënë, aty ku rrinë furgonat, aty është pisllicu më i madh. Shoferët janë të papërgjegjshëm totalisht. Ça marrin, e ça pastrojnë makinën, të gjitha i hedhin atje në kanal. Dhe ne jemi duke studiuar me bërjen e rrugëve, vendbazime të qarta se ku do të rrinë këta. Aty nuk do të rrinë më, po do të dalim ne me një skemë tjetër se çfarë do bëhet, ndoshta duke i bërë dy polet, anën veriore këtej dhe anën jugore, po themi të Lezhës. Plus që jemi duke bërë planin e transportit, siç e kemi miratuar këtu. Do e nxjerrim këto ditë, apo e kanë nxjerrë në prokurim, nuk e di, me një kompani e cila do të bëjë një studim të thelluar të gjithë problematikës që ka Lezha, do ta adresojmë. Tashi, këto punët e këtyre makinave, sa po tha zonja, se jeni tu i gjobit shumë. Tashti, i ti thu: "Jo, po hyjnë aty dhe s'duhet me i gjobit." Tashti, o t'i gjobisim, o mos t'i gjobisim, se ky muhabet është tashti. Me këto rrugë që kemi ne, i gjejmë sipër trotuareve, edhe normalisht s'kanë

vend ku mund të parkojnë, por ne e kemi hapur sheshin mbasditeve, mund të vijnë këtu në shesh, t'i parkojnë dhe dalin në këmbë, të shkojnë, ose ke edhe biznes privat. Për shembull, ke te Mileniumi, dy kate parking që s'shkon kush, me lekë të shkojnë aty t'i parkojnë, po nuk duan. Unë mendoj që me bërjen e rrugëve dhe ishalla, po adresojmë edhe parkimin nëntokësor, ne do ta heqim parkimin në qytet komplet. Do ketë lagjja Besëlidhja me kartë rezidenti, aq sa u takon banorëve dhe ne bile jemi duke menduar, jemi duke bërë një plan që përveç pedonales që do bëjmë tashti atje para gjimnazit që do e fillojmë, ne duhet të jemi duke e pa dhe komplet lagjen Besëlidhja me e fut në një cikël pedonale, domethënë komplet si lagje me e dizajnu një vend. Po ndërkohë duhet të kemi parkingun nëntokësor. Pra, në perspektivë, në qendër të qytetit, duhet të japim një karakter më atraktiv, si gjithë bota, duke e iu afruar parkingun.

-Ndue Luli: Faleminderit. Ka ndonjë gjë tjetër? S'ka. Faleminderit. Mbledhjen e deklaroj të mbyllur. Ju falenderoj. Mirutakofshim.

Shënim: Mbledhja u transmetua live në Facebook në faqen "Këshilli i Bashkisë Lezhë".

SEKRETARI

Florida Çunaj
8

KRYETARI

NDUE LULI
